

Kuvendi

Qarku Durrës

Arbjan Mazniku:

Përshëndetje, po fillojmë tani seancën e tretë të ditës mbledhëse. Një ditë maratonë që ka zgjatur në fakt gjatë, kemi filluar në orën pak pas orës 10 të mëngjesit, me dëgjuesën në fillim të Elbasanit, më pas të Kuksit, dhe tani kemi dëgjuesën e tretë me tre bashkitë e Qarkut të Durrësit. Unë mendoj që, duke qenë se e kemi bërë gjatë ditës, nuk ka nevojë që të bëjmë hapje të qensishme, sepse besoj që gjërat janë të gjata, të qarta dhe fokusi i diskutimit është i qartë. Kërkesa ime e vetme do të ishte, për çështje efieciënce kohore, do t'i lutesha të gjithë deputetëve të të gjitha krahëve të përqendrohemi tek pyetjet, tentojmë t'i mbajmë pyetjet e shkurtra, në mënyrë që të kemi efieciencë kohe, sepse duke bërë parashtrime dhe duke marrë ne si deputetë kohë, duke marrë ne si deputetë kohë të gjatë, në thelb hamë nga koha që do të ishte mirë që të dëgjonim në mënyrë efieciënte kryetarët e bashkive. Kështu që ky është i vetmi koment dhe kërkesë që do kisha, që të kemi një vijimësi efieciënte, megjithëse është edhe ditë e gjatë.

Luçiano Boçi:

Po, duke uruar mirëseardhjen e kryetarëve të bashkive të Qarkut të Durrës, edhe unë po e shmang atë parashtrimin që zakonisht e kemi si procedurë hyrje, por gjithsesi ajo që dua të vendos në vëmendje të kësaj dëgjese është që ne të mos ta bëjmë një dëgjese formale, por reale, e kemi pritur këtë moment, e kemi kërkuar, mos jetë thjesht protokollare, por vërtetë kryetarët paraqesin ato shqetësime që shpesh i kemi dëgjuar në forma dhe mënyra të ndryshme, për funksionet, kompetencat, por që lidhen me shërbimet, lidhen me përfaqësimin dhe në fund lidhura domosdoshmërisht me territorin. Pa e zgjatur fjalën, ia kaloj deputetit Cara.

Igli Cara:

Faleminderit, vazhdues të kësaj seance. Së pari.

Arbjan Mazniku:

Nis mikrofoni, mirë?

Igli Cara:

Ok. Së pari ju falenderoj që jeni këtu, përfaqësues të bashkive, duke filluar nga zonja Sako, zonja Kokalaj, zoti Arbana. Në fakt, besoj që ky debat mbi të gjitha do të jetë një debat që shkon për interes të qytetarit dhe kjo reformë që ne po bëjmë është administrative dhe territoriale dhe unë dua të kalojmë në fillim tek ajo çfarë quajmë ne te sistemi administrativ, ku është funksioni, kompetencat, kapacitetet, standardet e shërbimit, subsidiariteti e me radhë. Së pari dua të ndalem një hyrje tek ajo ndarja e kompetencave ose ndarja e pushteteve. Sipas Kushtetutës, pushtetet në demokraci janë të ndara dhe në këtë kuptim duhet të dija nga të gjithë ju, por në veçanërisht në fakt përsa i përket bashkisë së Durrësit, duke ju referuar pikërisht ndarjes së pushteteve dhe kompetencave. Ajo duket normale? Pyetja e parë është: Ajo duket normale me ndryshimet

e fundit, VKM 418/2025, në rregulloren e zhvillimit të territorit që lejet e ndërtimit, nuk po zgjatëm shumë, pavarësisht kushteve dhe kriterëve që ne kemi në kushtetutë, janë brenda zonës bregdetare, si dhe çdo objekt mbi gjashtëkate, kushtetutën e jashtëzakonshme, të jepen nga SHTE. Pra, kompetencë e kam pasur gjithmonë bashkitë, t'i kaloj kryeministrit. Sepse në konceptin tim, por edhe të specialistëve, kjo është ndërhyrje brutale e kryeministrit pikërisht tek kompetencat që ka bashkia. Vazhdojmë pastaj, a ju duket normale që për objekte të rëndësisë së veçantë, siç është porti i Durrësit, apo dhe investime të tjera, ndërhyjet përsëri nga qeveria dhe me vendime parlamenti dhe të falen pikërisht, përjashtohen nga taksat, pikërisht këto investime? Dhe këtu po i referohem portit të Durrësit, që siç ju e dini nga taksa, infrastruktura është 8% dhe strehimi 3%, 11%, projekti 2.1 miliardë euro, duhet të shkonin për bashkinë e Durrësit 231 milionë euro. A ju duket normale që nuk i shkojnë qytetarëve të Durrësit dhe i falen një investitori, qoftë dhe ai alebar, miku i Ramës? Vazhdojmë përsëri, keni premtuar se janë të lidhura ujësjellësin ose shërbimin me 24 orë ujë. Pak më parë e kishit ju si në administrim, apo jo? Dhe më vonë përsëri ndërhyri qeveria qendrore dhe tani është SHA dhe administrohet nga Ministria e Infrastrukturës, ky shërbim. A ju duket normale që për një shërbim që në mendimin tonë duhet të ishte kompetencë e bashkisë ose e bashkive në tërësi, të merret përsëri nga kjo ministri, pra nga qeveria qendrore? Vazhdojmë, përsëri kemi turizmin, një fushë të rëndësishme. Ju duket normale që edhe lejet, qoftë dhe për ato plazhet, për parcelat, për shërbimet, për turizmin, t'i vendosë Ministria e Kulturës dhe mos i vendosin bashkitë, mos i vendosni ju? Se ju keni bërë vendim këshillit bashkiak kur keni ndarë dhe përqindjet, plazhit publik dhe plazhit privat, por për të vendosur se kujt t'i takojnë parcelat, çuditërisht duhet ta vendosë dikush në Tiranë që është shumë pa sens. Vazhdojmë, ju duket normale që për shumë investime që bëhen në qytetin e Durrësit, vijnë në mënyrë të kushtëzuar dhe shumë nga fondet që dikur vinin në formën e transfertes pa kushtëzuar, tani më vijnë si investime direkte me anë të agjencisë ose të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, ku mund t'i bëni dhe ju? Ju duket normale që kryeministri ndërhy, i jep urdhër dhe pushtetit lokal që duhet të japin dorëheqjen dhe përfaqësuesit e bashkisë, qoftë nënkryetar apo drejtues pas fushatë? Sepse në fakt ne e dimë që në këtë vend kemi zgjedhje qendrore, zgjedhje lokale, kemi parlament dhe kryeministri është me votë deleguar se zgjidhet nga deputetët, kurse nëpërmjet pamjes juridike, kryetarja e bashkisë zgjidhet me votë direkt të qytetarëve apo kryetarja e bashkisë dhe më duket anormale që të marri dhe urdhër deri në këtë nivel. Tani për të vazhduar për financat, kam këtu të dhënat, tabelat. Sa është raporti juaj me bashkinë e Durrësit, i vlerës që shpenzohet për paga dhe shërbime, pra për administratën, në raport me të ardhurat tuaja, jo me të ardhurat e përgjithshme bashkë me grantet e kushtëzuara, bashkë me transfertat? E dua vetëm në raport me të ardhurat tuaja. Sepse më rezulton që pavarësisht se ju keni një rritje të madhe të të ardhurave totale, por më rezulton që kjo rritje vjen 129.8% nga të ardhurat e transfertave, siç janë transfertat që bëhen çdo vit, por edhe nga fondet e rindërtimit e me radhë dhe keni vetëm 35.9% të rritja të ardhurave nga ju. Në këtë argument jeni më dobët se bashkia e Kruës dhe bashkia e Shjakut. Sa është numri i punonjësve? Unë e kam, e kam marrë në mënyrë zyrtare, por nga viti 2015 që kemi bërë këtë reformë, në vitin 2026, flas dhjetor 2015, dhjetor 2026. Po pres përgjigjen tuaj, se unë e kam këtu. Sa është? Pra, ai premtimi që u bë që do të ulte numrin e administratës, pra ato para që shpenzoheshin për administratë do të shkonin për shërbim për qytetarin, është realizuar apo jo? Tani kemi, përsa i përket të ardhurave, përsa i përket taksave, ju keni taksat që gjeneroni vetë, por keni edhe taksa në fakt që janë taksa kombëtare. Kemi shumë taksa kombëtare në fakt që duhet t'i rikthehen edhe qytetit, nuk e kam vetëm për Durrësin, por duhet t'i rikthehen çdo bashkie në gjithë Shqipërinë. Por për t'u ndalur tek Durrësi, ne kemi taksa kombëtare dhe ne paguajmë shumë, paguajmë tek taksa e qarkullimit, kjo aksisa, këto të gjitha, por në fakt edhe tek kjo taksa e qarkullimit që ne e

kemi që duhet të rikthehet përsëri në shërbim rrugor. A nuk ju duket pa sens që të gjithë këto taksa, se makinat nuk qarkullojnë vetëm në rrugën Tirana-Durrës, por makinat qarkullojnë dhe brenda lagjeve të Durrësit, qarkullojnë dhe brenda një qarku, qarkullojnë dhe në çdo zonë të Shqipërisë dhe çuditërisht këto para që i merren nga qeveria qendrore, nuk kthehet asnjë lekë, asnjë zero, pikërisht për shërbim, pikërisht për njësitë, siç janë bashkitë apo komunat, apo jo? Përsa i përket një shpenzimi total që për trajtimin e mbetjeve, sa është për bashkinë e Durrësit? Sa është shpenzimi total për gjithë trajtimin dhe sa paguhen në mënyrë të veçantë për inceneratorët? Sa përqind të buxhetit? Dhe në vitin 2010, bashkia e Durrësit, në atë kohë ishte zoti Dako, ka firmosur një memorandum për trajtimin e mbetjeve që janë në mbulim, pra kanë kaluar 16 vite dhe bashkia e Durrësit nuk ka bërë asnjë hap, ku një pjesë të mirë jeni edhe ju. Kjo vjen për dy arsye: ose sepse kryeministri dha urdhër që mbetjet të dërgohen në Tiranë, të trajtohen në Tiranë dhe ju keni vetëm pjesën e transportit dhe të mbledhjes dhe të incenerohen në Tiranë, por këtë vlerë duhet të ma jepni të saktë, ose jeni të paafhtë që të bëni trajtimin e mbetjeve që në burim, pastaj siç keni premtuar dhe në fushatë dy herë rrjesht do të krijoni dhe vend depozitimi ku do të bëni dhe ndarjen e mbetjeve në plastikë, karton, qelq e me radhë, që kuptohet dhe këto gjenerojnë të ardhura, pra këto janë mungesë të ardhurash nga ana juaj. Doja të dija sa, kam një deklaratë, nuk e di, dua të ma konfirmoni, numri i turistave në Durrës kalon 1.5 milionë në vit? Kam të dhëna të tjera që kalojnë dhe 2 dhe është normale, në 11 milionë turistë që thotë kryeministri që vijnë në Shqipëri, Durrësi, duke qenë se është qyteti kryesor, besoj që duhet të jetë edhe afër 2 milionësh. Dhe këtu dua të di, nga 2 milionë turistë, te taksa e fjetjes, sa keni arkëtuar? E di që keni një rritje nga viti 2023, se keni qenë në shifra skandaloze, 27 mijë euro, 28 mijë euro, nëse s'kujtohet mirë, e di që keni rritje, por dua të di sa është këtë moment, në mbyllje të vitit 2025. Dhe përsa i përket procesit të rindërtimit, që pavarësisht se nuk ka të bëjë me reformën, por gjithsesi ka të bëjë përsëri me atë që quhet te kompetencat, se pa diskutim që ju paratë nuk mund t'i siguron dot si bashki, kjo është e evidente, sepse procesi i rindërtimit nuk mund të mbaroni t'ju. Por këtu e kam një pyetje: pse keni hezitur të pranoni që Komisionin Hetimor të kërkuar nga Këshilli Bashkiak për procesin e rindërtimit? Kjo është një pyetje në fakt që është jashtë, por në qoftë se mundeni të ma jepni. Dhe përsa i përket procesit të ujitjeve, kanalizimeve, flas në zonat rurale. Nga të dhënat që unë kam, ato nuk janë trajtuar. Mos harrojmë që kemi përsëri një ndërthurje të pushtetit qendror dhe pushtetit lokal për ujërat e larta, kemi Durrësit të përmbytur tre herë dhe çuditërisht edhe për Hidrovorin ka një ndërhyrje përsëri nga ministria, pra ju nuk, pavarësisht se jeni edhe ju pjesë, ka ardhur si pjesë e mekanizmit, i procesit dhe të Ministrisë së Infrastrukturës dhe a i ka vlejtur ky investim i Durrësit, 20 milionë euro që janë hequr nga fondi i rindërtimit dhe ju keni marrë një vendim në Këshill Bashkiak, rreth 20 milionë dollarë, a i ka vlejtur apo jo? Dhe a është e vërtetë deklarata e Ministrisë së Financave përsëri që thotë që ne i kemi dërguar të gjitha paratë edhe për bonus qerat dhe për investimet dhe këtu keni një përplasje me deklaratën e Ministrisë së Financave? Këto përsa i përket administrimit dhe e mbylla. E mbylla. Faleminderit për të vazhduar.

Aulona Bylykbashi:

Atëherë, me gjithë respektin për kolegun Sara, do të ishte mirë që të fokusoheshim tek qëllimi i kësaj dëgjese sepse një sërë pyetjesh në fakt krijonin përshtypjen sikur e kemi thirrur kryetaren e bashkisë këtu për interpelancë ose komision hetimor me çështje që nuk kanë të bëjnë fare me dëgjuesen publike për Komisionin e Reformës Administrative Territoriale, kështu që në një dakordësi të përbashkët jemi konçist tek ato pyetje që i shërbejnë këtij procesi dhe meqë e mora fjalën për procedurike, desha të ndaj edhe diçka në raport me, desha të ndaj edhe diçka në raport me kërkesën tuaj për të bërë një

përllogaritje të shpenzimeve për paga vetëm mbi të ardhurat e veta të bashkisë, besoj që nuk është një kërkesë e drejtë duke qenë se tek fondi i pagave llogariten edhe fondi i pagave për edukatorë, për zjarrfikës, të cilat janë funksione deleguara dhe që vijnë bashkë me grantin e kushtëzuar dhe nuk është raport i drejtë. Faleminderit.

Po, zotëri... Jo, jo, prit, për procedurë. Po, po, dhashë fjalën për procedurë.

Igli Cara:

E mirëkuptoj kolegjin dhe jam dakord që ndoshta duken pyetje sikur nuk kanë lidhje, por kjo pikërisht janë pyetje që dalin dhe pasqyrojnë pikërisht ndërhyrjen e pushtetit qendror tek ai lokal dhe prandaj i kam bërë. Pra, nuk është në kontekstin për të vënë kryetaren e bashkisë para një përgjegjësie e cila nuk është temë e diskutimit. Kur unë pyes sa është në raport me të ardhurat, pa diskutim këtu nuk e kam fjalën për ato të ardhura të deleguara, kuptohet që janë për shërbimet, se ne e dimë që arsimi është dyfunksional, ka pa diskutim arsimtarët që paguhen nga qeveria, por kanë dhe shkollat, janë të ndara dhe kryetarja e bashkisë jam e sigurt që e ka shumë të thjeshtë ta ndajë. Po, pa diskutim, unë isha i qartë, besoj edhe kryetarja e bashkisë më kuptoi, ndoshta s'ia thashë, apo jo? Pra, gjithsesi, në qoftë se ndonjë pyetje ju duket jashtë kontekstit, mundet, nuk ka problem, se bëhet dhe kërkesë.

Emiriana Sako:

Jo, jo, okej, do t'u përgjigjem për çdo gjë, jemi këtu për këtë arsye, por do të doja, sa kohë kam, që të kthej përgjigje, sepse meqenëse... Sepse çështja, domethënë, këto pyetje janë në mënyrë indirekte, disa prej tyre prekin çështjen e funksioneve të ndara qeverisë qendrore dhe lokale, por një pjesë tjetër janë shumë teknike. Unë një pjesë të shifrave e kam, ne jemi lajmëruar dje pasdite që jemi pjesë e kësaj dëgjese, le të themi, dhe sado që të jetë në një format pyetjesh, për të gjitha pjesën teknike që sot nuk kemi material me vete, do ja vëmë në dispozicion patjetër në bazë të pyetjeve që ju ngritët.

Arbjan Mazniku:

Dhe unë dua të bëj dy ndërhyrje të shkurtra për sqarim teknik. Së pari, ne si rregull kemi vendosur gjatë ditës së sotshme që tipikisht një pyetje duhet të qëndrojë, përgjigja duhet të qëndrojë te dy minuçi, por gjithashtu kemi dakordësuar që tipikisht përgjigjet duhet të jenë më të gjata se pyetjet, kështu që këto dyja kanë një pikëprerje diku shumë më larg se dy minuçi, kështu që për sa kohë që pyetjet ishin disa dhe të detajuara, kemi mirëkuptimin tonë, besoj që të merrni kohën për t'iu përgjigjur secilës prej tyre. Së dyti, e kemi diskutuar këtë dhe gjatë ditës së sotshme me të gjithë kryetarët e tjerë që për të gjitha pyetjet të cilat kërkojnë informacion specifik që duhet përpunuar nga ana juaj, ne do të bëjmë një zbardhje të dëgjësës, por do t'i kërkoj edhe të gjithë kryetarëve nëse kanë pyetje teknike që ne më pas t'jua përcjellim me shkrim, në mënyrë që të administrojmë teknikisht ato që kanë të bëjnë me numra, tabela, të dhëna historike apo specifike që na ndihmojnë për të kuptuar një element specifik. Sidoqoftë, fjala për ju.

Emiriana Sako:

Nëse ne jemi ftuar këtu sot për të folur për dëgjësën, unë do të doja që në parim të shprehja mendimin tim si kryetare e bashkisë së Durrësit, por edhe si kryetare e shoqatës së bashkive, së bashku me gjithë kryetarët e tjerë që janë pjesë e shoqatës, ne kemi dakordësuar, le të themi, apo kemi shprehur që shqetësimet tona do të fliten dhe do të artikulohen sa i takon çështjeve kryesore që janë funksionet dhe financat, sepse sigurisht

që vendimmarrjen për hartën mund të futemi në atë debat, por sigurisht do të mbetemi skillavë të debatit a duhet të ndryshojë X qytet apo Y territor, dhe mendoj që kjo është një çështje që i takon ekspertëve. Patjetër, gjithsecili nga kryetarët mund të ketë opinionin e vet, por e rëndësishme është që ne të fokusohemi tek ato gjëra të cilat ne gjatë kohës që drejtojmë, pra që mbajmë detyrën e kryetarit të bashkisë, i kemi hasur si sfida, si procese pune të cilat bëhen, por mund të realizohen dhe akoma më mirë. Unë kam nxjerrë disa çështje të cilat mendoj që duhen ndarë me këtë komision për arsye që të bëhet e mundur të reflektohen në materialin e plotë që do të finalizohet në fund. Së pari, ne kemi diskutimin e funksioneve të ndara, të cilat shpeshherë krijojnë një gabim midis në zbatimin dhe dhënien e shërbimit të qytetarëve. Funksionet e ndara mund të ilustroj këtu funksionin e kullimit, ujitjes, ku një pjesë e kompetencave për mirëmbajtjen e kanaleve të para dhe të dyta, apo edhe të treta, në zona të caktuara e ka bashkia e Durrësit, dhe një pjesë e ka bordi i kullimit që është në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, që do të thotë në këtë rast kemi mundësi që me reformën, me materialin, me bllokun ligjor që do të bëhet me reformën në përfundim të këtij procesi, mendoj që në vëmendje të komisionit dhe të ekspertëve duhet të jetë ndarja e saktë e funksioneve dhe e pasur, duke pasur mundësisht sa më pak mbivendosje me funksionet e tjera të qeverisë qendrore, le të themi. Së dyti, një instrument tjetër shumë i rëndësishëm është decentralizimi i funksioneve, i cili ka ndodhur, pra reforma e 2014-s apo e 2015-s, le të themi, 139-ta, ka caktuar funksione për njësi të vendore, të cilat gjatë 10-vjeçarit, nëpërmjet instrumentave të tjerë ligjor, VKM-ve apo ligjeve të ndryshme, për arsye të cilat janë vlerësuar për të dhënë një shërbim më të mirë për qytetarët, për të dhënë një shërbim më efikas për qytetarët, për të mbledhur më shumë taksa apo të ardhura, janë marrë vendime të cilat këto funksione ndahen midis pushtetit vendor dhe atij qendror, dhe mendoj që deri më sot nuk ka një legjislacion dhe nuk ka një rregullore se si fillon procesi i decentralizimit, kush e nis, pra është politik apo është teknik shpeshherë, dhe ky proces si do, a do duhet të ketë një metodologji se si ndodh, dhe patjetër që mendoj që bashkitë duhet të jenë pjesë e këtij procesi, e kësaj vendimmarrje që në krye të herës që vendos se do të decentralizohet një funksion. Nga ana tjetër, mendoj që një element tjetër shumë i rëndësishëm për bashkitë janë financat dhe të ardhurat, të ardhurat e veta. Jo të gjithë qytetet kanë të njëjtin format, jo të gjithë qytetet kanë një të ardhura financiare dhe ekonomike apo zhvillim ekonomik, kanë tipologji të ndryshme, numër të ndryshëm popullsishë, zhvillim të ndryshëm territor dhe përfitime të ndryshme nga territori, dhe mendoj që është e udhës që taksat e ndara, të cilat deri më sot ne kemi vetëm katër prej tyre, të shihet mundësia që qytete të mëdha, të paktën siç janë Durrësi, Tirana, Vlora, që kanë dhe një dinamikë të rëndësishme me zhvillimin ekonomik për arsye të turizmit, të kenë mundësi të marrin të ardhura direkt nga taksat e ndara, duke bërë të mundur që në këtë moment transfertat e kurzuar apo të pakurzuar të qeverisë të fokusohen në ato bashki të cilat janë më të vogla ose të cilat nuk kanë potencial ekonomik. Kjo sigurisht do të bënte një lidhje të drejtpërdrejtë dhe një interes të drejtpërdrejtë të kryetarit të bashkisë për të rritur numrin e biznesit në territoret përkatëse, për të incentivuar në mënyra të ndryshme. Mendoj që këto janë elementë të cilët vijnë si diskutime tona të brendshme dhe mund të artikuloohen, mund të diskutohen edhe me pjesën teknike, a ka hapësirë për t'u realizuar apo jo. Më tej, për t'u kthyer tek pyetjet e deputetit Sara, sigurisht që një pjesë të tyre, pra si plazhet, lejet e ndërtimit, unë e preka që janë funksione të cilat ndahen midis qeverisë dhe bashkisë.

Arbjan Mazniku:

Zonja Sako, ndjesë që ju kërkoj që ju ndërpres, por unë besoj që do kemi dhe dakordësinë e bashkëkryetarit dhe të opozitës që në moment të caktuar, përveç dëgjësave që bëjmë me bashkitë respektive, ne të bëjmë një dëgjese formale me shoqatën e bashkive, në të

cilën shoqata e bashkive, me kryesinë e saj dhe me stafin, të vijë dhe të prezantojë në një moment të caktuar pozicionin e bashkive për çështje specifike, në mënyrë të më të strukturuar, duke vlerësuar dhe hapin që ju bëtë dhe si kryetare e shoqatës së bashkive, por besoj që në një moment të caktuar do të duhet ta bëjmë një dëgjese ku, përveç pozicionit tuaj si kryetare e bashkisë së Durrësit apo e Eltonit si kryetar i bashkisë së Shijakut, shoqata të sjellë pozicionin e bashkive për çështje specifike. Kështu që do ta bëjmë këtë gjë, e vlerësoj shumë dhe sugjerimin, por besoj që do të jetë një moment që, pasi të bëjmë këtë proces do të kemi një moment shumë të detajuar për një dëgjese të mirë dhe të gjatë për këtë çështje. Thjesht ndërhyrje për... Për të kuptuar që nuk po jua dëgjim këtë çështje sot.

Emiriana Sako:

Nuk është se isha duke folur vetëm në emër të... Në sensin, ajo hyrja e diskutimit ishte që në përgjithësi me kryetarët kemi vendosur që të flasim për funksionet dhe për gjërat që mendojmë që mund të bëhen më mirë, apo për financat që mund të kenë munguar në funksione të caktuara, sepse ju i keni tashmë në tavolinë shifrat e realizimit të funksioneve nga ana e bashkisë. Janë 41 funksione dhe mbi 50% të tyre pothuajse realizohen nga të gjitha bashkitë, ndërkohë ka funksione të cilat ne duhet ta pranojmë që kanë nevojë për t'u përmirësuar, por nga ana tjetër asnjë kryetar i bashkie nuk i duhet t'i delegohen funksione të cilat nuk shoqërohen me financat përkatëse. Ne kemi çështjen e emergjencave civile, e cila është një çështje shumë e ndjeshme dhe qytetet tona çdo vit e më tepër përballen me sfida të ndryshme, qoftë rreshtet e shumta, përmytjet. Në rastin e Durrësit kemi pasur tërmete, kemi pasur zjarre, por dhe pandemia, pse jo, të cilat janë renditur në një kohë relativisht të shkurtër. Gjykojmë që çështja e emergjencave civile, që sot ka një ligj që thotë 4% të buxhetit duhet t'i transferohet bashkive, kjo nuk është zbatuar asnjëherë në këtë shifër, që do të thotë ne funksione të cilat i kemi të ngarkuara për t'i zbatuar me ligj, duhet patjetër që t'i kemi të shoqëruara me financa, në mënyrë që të jemi operativë në terren dhe patjetër që gjithë ky diskutim pastaj përkthehet në mënyrë të përgjithshme kur themi shërbim ndaj qytetarëve. Siç e thashë, unë kam disa shifra me vete këtu, jo të gjithat që kërkoi deputeti. Mund të flas për buxhetin shkurtimisht për taksat e bashkisë. Ne mbledhim 56% nga gjithë buxheti i bashkisë, pra rreth 62 milionë dollarë, mbledhim rreth 56% janë taksat tona, 6% janë taksat e ndara dhe 39% janë transfertat. Tani, te taksat e ndara futen taksat e renta minerare, qarkullimi i mjeteve, taksa e kalimit të drejtës së pronësisë dhe pasurive të paluajtshme, dhe 2% e të ardhurave nga tatimi për të ardhurat personale. Ju e kishit specifikisht tek taksa e qarkullimit. Tani, unë këtu po e cituat me idenë që këto taksa vijnë dhe nuk jepen shërbime në qytet. Ky është një debat që mund të shkojë gjatë, mund të shkojë pafund. Unë mendoj që ne kemi bërë investime në qytet për sa i takon investimit në infrastrukturë, kemi bërë investime për... Ne do donim të kishim më shumë, ne do donim të kishim më shumë, do donim të kishim më shumë, sepse kjo taksë, kjo taksë që ne e vjelim, zë rreth... i kalojnë bashkisë së Durrësit rreth 25%. Kjo zë, domethënë, ne na intereson që ta kemi edhe më të lartë mundësisht, sepse në territorin e bashkisë së Durrësit kemi një numër shumë të lartë të automjeteve të cilat qarkullojnë në territorin tonë dhe pse jo. Këto janë sa i takon diskutimet. Ndërkohë, nga buxheti, ne nga ky buxhet ne investojmë 44%, i kemi investime, pagat sigurime shoqërore zënë 30% dhe shpenzimet operative janë 26%. Po ja, pra me përqindje po ta them. Totali, pra, është 30%. Paga sigurime shoqërore është 30% totali. I buxhetit të vitit të fundit, pra ai që kemi miratuar në 2025-ën. Pastaj, procesi i rindërtimit, procesi i rindërtimit, më fal. Dëgjo, këto ka një ligj për këtë. Ne sot ka një ligj që është ligj për investitorë strategjik.

Unë nuk jam këtu për të mbrojtur projektin e marinës, ai është një projekt në zhvillim. Kur është bërë projekti, më dëgjo pak lutem, se unë nuk ju ndërpreva. Ju bëtë të gjitha pyetjet, unë mbajta shënime, tani ta mbaroj dhe unë, ose e kthejmë debat. Jo, nuk mërzhitem, jo. Ne nuk jemi këtu për të diskutuar për projektin e marinës. Ai projekt, kur është, kur ka filluar, ne kemi bërë dhe një sondazh. Nga sondazhi që bëmë, rreth 70% e qytetarëve të Durrësit e vlerësonin si një investim të duhur për qytetin. Është një investim i cili do të sjellë patjetër marka ndërkombëtare të hoteleve, do të sjellë investime në infrastrukturë dhe ne do të përfitojmë sipërfaqet e sipas kontratës dhe sipas ligjit që është në fuqi, por do të fitojmë edhe gjitha ato hapësira publike ku ne do të kemi akses, sepse ne e dimë shumë mirë që gjithë qytetarët e Durrësit e kanë pritur gjithmonë aksesin ndaj portit dhe porti sot është një territor i mbyllur dhe është një territor i cili nuk aksesohet nga qytetarët. Ky projekt do t'i japi mundësinë. Nga ana tjetër, të njëjtin model investimi, ku ata që sjellin marka ndërkombëtare të hoteleve, ne kemi tashmë në Durrës hotele të shumta të cilët kanë bërë një investime. Sigurisht kanë pasur, le të themi, mbështetje në formën e mbështetjes së taksave sa i takon qeverisë qendrore, por këto janë marka të cilat e fusin Durrësin në një hartë e cila është shumë e rëndësishme që ne më tej të flasim për rritjen e turizmit. Nëse ne sot flasim, unë nuk dua të përmend emra, sepse këtu jemi dhe në televizion, por në Durrës kemi markë ndërkombëtare "Movempikun", kemi "Melin", që këto nuk i kanë sjellë asnjë dëm qytetit të Durrësit, zoti Sara. Kështu që edhe ky investim, edhe ky investim për arsye të benefitit që do të ketë qyteti afatgjatë, ne patjetër jemi në pro tij dhe na duket një investim shumë i rëndësishëm për qytetin e Durrësit dhe do të jemi mbështetje. Nuk po devijoj, kjo është përgjigjja ime. Unë nuk jap dot përgjigjen që do ti... Ti ke pyetjen tënde. Shiko, ky të thashë kjo është e bazuar në ligj. Ti po bën një pyetje, ti po bën një pyetje këtu që është e... që je...

Arbjan Mazniku:

E mbron, zoti Cara, zoti Cara, e mbron juve. Kryetarja e bashkisë ju dha përgjigjen e vetë dhe besoj që kjo historia që e du përgjigjen siç e du unë, nuk ia jam kushtuar. Po dha pra përgjigjen që tha, sa është... Tani, nuk i hyjmë diskutimit dot me njëri-tjetrin se nuk më duk përgjigjja siç e mendoj unë që duhet të jetë.

Emiriana Sako:

Po jo, për t'u përgjigjur për këtë edhe thashë mendimin tim. Po, s'pëlqen, pastaj është diskutim tjetër. Folët për procesin e rindërtimit. Rindërtimi është, pra, unë si titullare e bashkisë, si kryetarja e bashkisë, kur kam një vendim nga Instituti i Ndërtimit, pra pas rindërtimit, një muaj pas doli akti normativ numër pesë, ku specifikonte mënyrën se si bëhen të gjitha procedurat, pra që është ligj, pra që është i miratuar në parlament, ku specifikonte të gjitha procedurat se si realizohet vendimmarrja. Dhe në rast se unë kam një akt konstatimi dhe një ekspertizë të thëlluar nga Instituti i Ndërtimit, i cili është instituti teknik më i lartë që merr vendime për qëndrueshmërinë e objekteve, jam e detyruar të ndjek procedurat përkatëse. Pse i transferuam këtë fond? Sepse ishte shumë e rëndësishme që ky objekt të ndërtohej. Për t'ju përgjigjur nevojave që ka qyteti, sepse dihet që Durrësi, Hidrovori i vjetër është i 1962-shit, nëse nuk gabohem tani, dhe Durrësi ka pësuar një ndryshim demografik shumë të madh. Ju e dini, ne jemi dëshmitarë që të gjithë jetojmë aty dhe patjetër që ky investim, objekti i vjetër, nuk e kishte më qëndrueshmërinë dhe për t'iu përballuar këtij fluksi, u ndërtua objekti i ri. Ne, falë rindërtimit, ju citoni vetëm këtë objekt, por kemi bërë rreth 42 shkolla të reja që... Nuk pyete këtë, po po ta them, sepse nuk mund, po nuk mund të themi që nuk duhen ato objekte. Pra, ai është një objekt, ai është një investim publik. Për të shkuar tek... Për t'u kthyer... Po pra, dakord. Po më bën 20 pyetje, unë do marr, unë pyeta sa kohë kam, nuk

më latë limit kohe, unë do përgjigjem. Tani ju thoni që pse nuk... Unë po të përgjigjem, fal, pyete ti për Hidrovorin, apo jo? Po të kthej dhe pyete, dhe pyete, dhe pyete pse nuk e ngrini atë komision hetimor në këshill? Nuk e ngrij unë, është këshilli bashkiak që e voton komisionin hetimor. Unë, ju keni bërë një... Më fal, të lutem, ju keni bërë një shkresë para disa ditësh në Bashkinë e Durrësit dhe kërkoni një informacion për rastin e Hidrovorit. Mund të bëni kërkesa 10 kërkesa në ditë, 20 kërkesa në ditë, do merrni përgjigje për ato që kërkoni. Kush ka kërkuar informacion nga Bashkia e Durrësit? Ka marrë edhe anëtarët e këshillit që përfaqësojnë forcën tuaj politike dhe ata të Partisë Socialiste. Kanë bërë kërkesa, kanë marrë përgjigje, është kaq e thjeshtë. Komisioni votohet në këshill, nuk jap dot përgjigje, unë s'kam kompetenca aty. Pastaj bie që edhe këtu ke këtë diskutim reformës, po mbivendosim, po kërkojmë të mbivendosim kompetencat. Mbetjet, po, ne për mbetjet, unë shifrën e saktë do më duhet t'ju jap të saktë me shkrim, mbase edhe anëtarëve të komisionit, por kemi rreth 240 milionë lekë të reja, të cilat vendosen për mbetjet e menaxhimit të mbetjeve të Bashkisë së Durrësit. Kjo mbetje nënkupton një sasi të konsiderueshme ditore që gjatë sezonit dyfishohet apo trefishohet dhe shkon proporcional me numrin e popullsisë. Në 2026-ën, qeveria nena ka transferuar 2.5 milionë dollarë si transfertë, sepse e kemi marrë angazhimin që kur është bërë pastaj plani i mbetjeve, që menaxhimi i mbetjeve, pra tarifa e depozitimit për Bashkinë e Durrësit do të mbulohet nga qeveria shqiptare. Përveç kësaj, ne kemi dhe një kontratë që e operon AKB-ja gjatë sezonit turistik, që është kryesisht në të gjitha bashkitë bregdetare, ku bëhet pastrimi i territoreve shëtitore apo rrugë në zonën e vjeshtë bregdetare dhe për të thënë të vërtetën, kjo na ka ardhur si favor, le të themi, sepse na ka ndihmuar në procesin e punës tonë, pasi gjatë sezonit turistik ne kemi sfida të mëdha në terren. Sa i takon asaj që ju thatë që ne kemi marrë një angazhim, po, është e vërtetë për të bërë stacionin e transferimit, sepse besojmë që kjo shifër dhe Bashkia e Durrësit paguan për landfill atje, jo për incenerim të mbetjeve, pra për depozitim. Dhe ne jemi duke punuar me KfV-në. Kemi përfunduar projektin e stacionit të transferimit, ku te stacioni i transferimit kemi futur dhe elemente të tjera të cilët janë teknikë për trajtimin e mbetjeve, riciklimin e tyre e të tjera me radhë. Sigurisht që kohët që donatorët punojnë janë më afatgjata sesa ato me të cilat ne operojmë, por do të presim që ata të bëjnë gjithë procedurat e tyre, miratimet përkatëse, për të filluar procesin e ndarjes, për të filluar procesin e diferencimit, ngritjen e stacionit të transferimit dhe më tej procesin e diferencimit të mbetjeve, i cili do të dojë një angazhim të madh, jo vetëm nga ne që drejtojmë, por edhe nga gjithë qytetarët për t'u bërë realitet. Në vija të përgjithshme, këto ishin ato që unë kisha. Pjesën e plazhit, le të jetë e ndërtimit, ujësjellësat, unë ti preka me nevojën për ndarjen e funksioneve, ato që quhen shared functions apo funksione të ndara, të cilat ndahen midis qeverisë qendrore dhe qeverisë lokale. Këto funksione unë ia kërkoj komisionit që në këto funksione të jetë më i saktë, i prerë, i ndarë, në mënyrë që ne të dimë kompetencat që kemi vetë dhe kompetencat që nuk i kemi. Sot, për të ilustruar, ju përmendët plazhet. Ne, për të thënë të vërtetën, nga ky ndryshim kemi pasur rritje të numrit të të ardhurave për plazhet, për të thënë të vërtetën, ndërsa në përgjithësi, për të dhënë një shërbim më të mirë ndaj qytetarëve, është më e rëndësishme që funksionet të diferencohen, pra të jenë të ndara saktë se çfarë detyrash ka bashkia dhe të ndara saktë çfarë detyrash ka qeveria, në rastin e mbivendosjes, si me thënë, me agjencitë nënministrore. Se unë përmenda rastin e kanaleve kulluese, kur vjen puna që ka rreshje apo që ka nevojë për vaditje dhe kullim, ne mund të bëjmë një fragment punës. Në qoftë se nuk e bën fragmentin tjetër të punës sektori përkatës, atëherë ky shërbim nuk arrin deri tek fundorët. Kështu që për këtë është e rëndësishme që këto funksione të detajohen në mënyrë të saktë. Besoj se ligji i 139-të i 2015-s i ka pasur këto të evidentuara qartë, por duke qenë se reforma bëhej për herë të parë, me siguri tashmë ka vend për ta përmirësuar. Shumë faleminderit. Shikon numrin e turistëve, unë di që ju do keni në dëgjese edhe ministritë e linjës dhe agjencitë përkatëse.

Numri i turistëve ne na figuron 1.5 deri në 2 milionë persona që vijnë në Durrës dhe jo vetëm gjatë tre muajve, por që fillon kryesisht sezoni në fundin e prillit, fillimin e majit dhe sipas kohëzgjatjes, por një statistikë të saktë qeveria e ka në nivel qendror. Ne, mënyrën se si i nxjerrim këto shifra, krahasojmë të dhënat që marrim nga porti, nga mund të jetë ky një diskutim që duhet të vlejë, si me thënë, dhe për ministrinë. Nuk e kam këtu me vete, do më japësh pak kohë, mbase përgjigjem deri në fund. Jo, jo, se e di, e ke ngritur edhe në fushatë këtë kur ke qenë vetë kandidat që e kishe kështu si kalbëteje, por për pak minuta do të kthej përgjigje për këtë.

Igli Cara:

Atëherë, kryetar, mundet një koment, jo më shumë se tre minuta? Atëherë, së pari, për sa i përket pyetjeve, edhe e mirëkuptoj shpeshherë dhe devijimin nga pyetja konkrete, por besoj që doli e qartë që funksionet apo shërbimet apo funksionet e ndara shpeshherë ndërthuren dhe ajo çfarë ne kemi shqetësim, pikërisht te ndarja e pushteteve, pra ndërhyrja e pushtetit qendror te pushteti lokal, doli evident. Pavarësisht se kryetarja e bashkisë e pranon që mirë është që të ndahen, por është de facto, është fakt që kryeministri Rama ka ndërhyrë dhe tani më nuk është vetëm kryeministër, por është dhe kryetar i gjithë Shqipërisë me këtë VKM që për sa i përket lejeve të ndërtimit, është kryeministri që vendos dhe nuk janë më kryetarët e bashkive, nuk janë ato që votohen nga qytetarët. Kjo tani u pranua. Për sa i përket gjithashtu, u pranua dhe që plazhet tani më janë kompetencë e ministrisë. Ju pranuat faktin që janë rritur të ardhurat dhe kjo tregon atëherë që më parë nuk janë bërë mirë punët nga bashkia. Po, po, po. Pra, por gjithsesi, edhe aktualisht, në këtë moment që flasim, mbi 50% të plazheve akoma nuk kanë marrë leje, pavarësisht se në vitin e kaluar, në aplikimin e nëndorrit, edhe ju e keni të ngritur këtë shqetësim pikërisht nga Shoqata e Turizmit, me sa di, të Durrësit. Ra të dakord për atë që unë thashë për taksën e rrugëve dhe vjen mirë që e pranoni që Bashkia e Durrësit nuk merr asnjë lekë, pavarësisht se i takon nga ajo taksa e qarkullimit, sepse atëherë... Po pra, si e merrni ju këtë? Të kujt?

Po, po, pra, por gjithmonë e merrni nga qeveria me projektet, jo me projektet e juaja, nuk ju vjen juve. Po, vjen e kushtëzuar apo e pakushtëzuar? Jo, pse është kështu? Ja, se e kanë me rrugë.

Nga ajo fakti që e ka marrë nga dyqani i parë.

Arbjan Mazniku:

Eh, vjen si pjesë, ajo vjen fond i lirë, e merr bashkia dhe ajo mos e dorëzon.

Igli Cara:

Vjen 25%.

Arbjan Mazniku:

25%? Po, 25%, po vjen fond i lirë. Është shumë pak. Atë e bëjmë diskutimin. Unë po them, po flas për faktet, jo për...

Igli Cara:

Ok. Pa diskutim, sepse për këtë po themi, në momentin që ndërhyrja qeveria qendrore dhe merr ato para që i takojnë pushtetit lokal, normal që performanca e pushtetit lokal pastaj

do të jetë më e dobët, duke shtuar këtu dhe arsye të tjera. Gjithashtu, edhe për sa i përket portit të Durrësit, bëhet më tepër një... tregohet që sondazhet ka qenë, nuk është e vërtetë, në sondazhet që unë kam podeshe ju dërgoj një kopje, është më shumë se 55% janë kundër, dhe aq më tepër ai është një rast tmerrsisht abuziv, dhe unë pritja në fakt që ju të thoni që po, ato para mirë është që t'i merrni qytetarët e Durrësit dhe të mos i falësh janë alebarit, sepse në të njëjtën analogji, zonja kryetare, unë do ju thoja, po për të gjithë gjirin e Durrësit ku kanë investuar vetë qytetarët e Durrësit, ato e kanë pare që nuk e kanë me djersë, apo vetëm paratë që investohen nga miqtë e Ramës falen taksat, sepse të më thuash kështu që nuk ka nevojë qytetarët e Durrësit se duhet të falë, sepse... po jo, kështu thatë, sepse ju e përmendët qartë që është një investim që i vlen. Kjo pastaj është... mos pranosh realitetin, se të më thuash që nuk i duhen 231 milion euro qytetit të Durrësit, po i vlen më shumë alebarit, kjo besoj që nuk ju shkon.

Emiriana Sako:

Ajo është edhe vizioni. Në momentin që ti zgjedh që në vendin tënd të zhvillosh dhe të sjellësh disa marka ndërkombëtare, të cilat jo në afat të shkurtër, por në afat të gjatë do të sjellin një zhvillim të madh për qytetin.

Igli Cara:

Në cilin?

Emiriana Sako:

Si në cilin? Po do pyesësh.

Emiriana Sako:

Sepse mbasi kemi parë që janë zhvilluar këto hotele me marka ndërkombëtare, të cilat nuk kanë paguar taksën e infrastrukturës, por kanë sjellë investime të tjera të rëndësishme për turizmin. Kaq, është çështje vizioni.

Igli Cara:

Mund të ma lexosh dhe pastaj merre prapë fjalën. Dhe atëherë që të kuptoni, ka një nen në Kushtetutë ku të gjithë janë përballë ligjit dhe janë të barabartë, dhe nuk mundet që disa të përjashtohen nga taksat dhe investitorët shqiptarë të mos përjashtohen. Dhe prandaj po them që më duket e palogjikshme që ju ta pranoni këtë duke qenë kryetar i bashkisë, se keni interes që të keni sa më shumë para për t'i shërbyer qytetarëve. Gjithsesi, për sa i përket pikërisht devijimit të fondeve nga 20 milion euro që ishin për qytetarët e Durrësit për IDK të Dërrvorit, ma bitëm dhe mos ja ngecni ose mos ja kaloni fajin tek Këshilli Bashkiak, sepse është iniciativë e juaj dhe ju, së pari, unë ju kërkova të shprehni opinionin tuaj. Pra, ju keni qenë dakord që këto para mos shkojnë për qytetarët, për rindërtimin, por të shkojnë pikërisht për IDK-në. Dhe pasojat e IDK-së, mënyra se si është ndërtuar, se ju kam dërguar edhe shkresë siç thatë, dhe shpresoj që do e marrë shpejt përgjigjen, dhe si është bërë, dhe përmbytjet që ka marrë qyteti i Durrësit, këtë pastaj e dimë dhe për dëmet. Akoma sot, megjithëse janë bërë dy përmbytje, qytetarët nuk kanë marrë dëmshpërblimet, por kjo është prapë diçka tjetër. Dhe për sa i përket investimeve që t'i kthehen qytetarëve, mos harrojmë që edhe për sa i përket shërbimeve sociale, qendrat për pensionet, për pensionistët, për fëmijët, të gjitha, ne e dimë se çfarë ka ndodhur në qytetin e Durrësit. Jo më larg se para disa ditësh patëm ndonjë fatkeqësi, sepse fëmijët në Durrës, në 90% të rasteve, luajnë në rrugë, sepse nuk i keni këto, ato

sheshet ju i keni dhënë për ndërtime dhe kulla, sheshet që mund të ishin shumë mirë kënde, por gjithsesi, për të kaluar tek mbetjet, më vjen mirë që e pranuat faktin e memorandumit, po keni 16 vite pas që nuk keni bërë asnjë hap dhe akoma prisni KfV-në.

Emiriana Sako:

Po nuk kemi fshehur ndonjë gjë nga këto, sepse si më thua, më vjen mirë që e pranuat.

Igli Cara:

Tani, për sa i përket turizmit të të ardhurave, zonja Saku, më thatë që vijnë 1.5 deri në 2 milion. Tani, të më thoni që vijnë 1.5 deri në 2 milion, sikur një natë ato të flenë në Durrës, një natë, me 1.5 që e keni tarifën e fjetjes, do të ishin rreth 2.5 deri në 3 milion euro të ardhura. Mund të më thoni, e kaloni 150 apo 200 mijë euro? S'keni as 10% të ardhura. Dhe ne flasim pastaj për turizëm.

Arbjan Mazniku:

Zoti Çara, të lutem.

Igli Cara:

Po, jo, e mbarova dhe një minutë ose tre sekonda, jo më shumë.

Arbjan Mazniku:

E para kemi, pra, kemi filluar para 45 minutash.

Igli Cara:

E marr më vonë, ke hartën.

Arbjan Mazniku:

Kemi filluar para 45 minutash dëgjuesen, fiks para 45 minutash. Në këto 45 minuta, koha është ndarë pothuajse gjysmë për gjysmë, midis jush dhe zonjës Simëriane. Pra, kemi më shumë se 25 minuta dhe për më shumë, një pjesë jo e vogël e çështjeve, të cilat mund të jenë një diskutim mbi performancën buxhetore të bashkisë specifike, nuk flasim për çështjen e përgjithshme, ju flasim si impakton kjo Krujën apo Shijakun, në mënyrë që të kuptojmë çfarë duhet të ndërrojmë në tërësinë e sistemit. Pra, duke kuptuar që do e merremi një çështje, po duhet të shohim kjo çështje a na çon te një diskutim tjetër, nëse do bëjmë një diskutim për performancën e bashkisë, e bën Këshilli Bashkiak, ia kalon ligjit e tyre ta kontrollojnë.

Luçiano Boçi:

Po, tani shqetësimet e zotit Çara janë për funksionalitetin, për autonominë financiare, se të lidhura janë ato me njëri-tjetrin, për kompetencat, dhe ai po e konkretizon.

Arbjan Mazniku:

Kishte një seri pyetjesh, në kërkim ndjesë, ishin një seri pyetjesh që ishin shumë të drejta dhe shkonin atje.

Luçiano Boçi:

Po, janë shumë të drejta dhe një seri pyetjesh, por për të cilat ai nuk mori asnjë përgjigje dhe po bën komente për mosmarrjen e përgjigjeve. Dhe në këtë rast duhet t'ia lëmë kohën në dispozicion, se t'ia numërojmë 45 apo 55, ai nuk ka ardhur këtu që mos mbarojë. Do mbarojë, por do mbaronte në qoftë se do merrte përgjigjen e pyetjeve.

Ermal Elezi:

Për procedurën.

Luçiano Boçi:

Po ta mbaroj unë, se procedura është që vjen pasi të mbaroj unë fjalën. Dhe s'kemi pse i ndërhyjmë, dhe ne s'po i ndërhyjmë kryetares së bashkisë, që e merr fjalën kur e mendon që duhet ta marrë, sepse ne e drejtojmë, dhe e kemi lënë edhe debatin paksa të lirë. Dhe unë mendoj që është përdor paritet në këtë rast, dhe mos... ndërkohë që morëm kohë, do kishte përfunduar edhe ky debat, mendoj unë. Kështu që, zoti Elezi, po fjala për ju.

Ermal Elezi:

Atëherë, me gjithë respektin, nëse ne këtë komision i ftojme kryetarët në dëgjesa, por në vend se të bëjmë dëgjesa, mbajmë fjalime, japim komente politike dhe nuk kërkojmë përgjigje pyetjeve tona, por në çdo rast përdoret për këtë, unë mendoj që e interpretova ndryshe gjithë mënyrën se si duhet të bëhen seancat. Tani e kuptoj protagonizmin politik që mund ta ketë secili, por nuk ka lidhje të bëhet në këtë seancë. Këtë seancë bëjmë pyetje dhe pyetja parashikon që të jetë më e shkurtër se përgjigjja, jo bëhet pyetja tre herë më e gjatë se përgjigjja. Dhe bëhet pyetje, s'bëhet hyrje, bëhet hyrëse, preambul, bëhet ca pyetje shtesë, bëhen pastaj, nuk më pëlqeu përgjigjja si e dhe, do japësh përgjigjen që si e bëj unë dhe pastaj dhe ca komente shtesë. Ju lutem, ta optimizojmë kohën, se humbet thelbi.

Luçiano Boçi:

Zoti Elezi, dakord jam unë, optimizimi i kohës duhet, por edhe ty metodologjinë e pyetjes, këto janë veçori të ligjërimit që secili ka prej nesh. Ne s'jemi në provim këtu, pyetja është kaq, përgjigjja është më e gjatë se pyetja, tani mos dalim. Ka nevojë... Jo, ka një gjë. Kjo është dëgjese me kryetarët e bashkive dhe është kuazi publike, sepse e tha edhe vetë kryetarja, është nëpërmjet televizionit. Dhe në qoftë se zoti Çara bën një pyetje teknike shumë të thatë, ai qytetari fundor i Durrësit nuk e kupton përmbajtjen e pyetjes. Dhe zoti Çara e gjykon që duhet të japë edhe një sqarim nëpërmjet një parashtrimi. Kaq e thjeshtë është. Ne do të donim të kishim më shumë kohë, se e dimë që jemi në atë këmishën e forcës së kohës, por ta shfrytëzojmë edhe duke sqaruar njerëzit, por edhe duke marrë një përgjigje nga ata që merren direkt me ushtrimin e pushtetit vendor në territoret e tyre. Dhe ai po e thotë, nuk ka asnjë qëllim as politik, as personal, thjesht një shqetësim të qartë qytetarë. Kaq, se çfarë protagonizmi ka? Ai është deputet, zonja Saku është kryetare e bashkisë, s'ka protagonizëm këtu. Po. Vazhdojmë? Po, zoti Axhinas, po fjala për ju.

Edmond Haxhinasto:

Faleminderit, zoti bashkëkryetar. Faleminderit, nderuar kryetarë të bashkive. Faleminderit për prezantimin. Unë në fakt kam një pyetje dhe dëshiroj që t'i përgjigjem në një mënyrë sa më të shkurtër secili prej jush. Ne kemi një diskutim për sa i takon cilësisë së shërbimeve që i ofrohen qytetarëve. Dhe unë dua të di përshtypjen tuaj nëse... E para njëherë dua t'ju pyes, nëse ju keni probleme me burimet njerëzore nëpër bashkitë tuaja,

për të pasur kapacitete cilësore në bashkitë tuaja, nëse niveli i pagave është i mjaftueshëm, domethënë i përshtatshëm për të garantuar një cilësi përkatëse për shërbimet. Dhe pyetja e dytë është, nëse ju në eksperiencat tuaja dhe në veprimtarinë e përditshme gjykoni se madhësia e bashkisë suaj ndikon në cilësinë e shërbimeve që i ofroni për qytetarët. Faleminderit.

Emiriana Sako:

Faleminderit për pyetjen. Unë po i përgjigjem shkurtimisht për t'i lënë kohë edhe dy kolegëve të tjerë. Në qoftë se... Ishte për të tre. Atëherë, për sa i takon burimeve njerëzore, ne... Viti që bëri ndryshimin dhe të nivelit të pagave, që është shumë pozitiv për të afruar pranë institucioneve publike persona të kualifikuar. Megjithatë, edhe pse Durrësi është qyteti i dytë në Shqipëri për nga madhësia, ekonomia, le të themi, zhvillimi dhe kapacitetet njerëzor patjetër, ne sërish kemi sfida për të pasur, për të marrë në punë inxhinier apo arkitekt. Të gjithë profesionet e tjera janë më të thjeshta, por ky është një sektor i cili ka dhe një kompleksitet, vështirësi të punës të caktuar. Dhe në përgjithësi, sa herë që hapim konkurse për këtë kategori profesioni, kemi vështirësi në pjesëmarrje në konkurrim. Kjo është pyetja e parë. Sa i takon madhësisë së bashkisë suaj në raport me shërbimin, ne gjykojmë që gjithsecili nga kryetarët ka për të thënë për mënyrën se si jepen shërbimet apo për nevojat që mund të ketë për shërbimet. Pavarësisht dimensionit të territorit, mendojmë që bëjmë maksimumin dhe për të dhënë shërbimet, duke i krahasuar me çfarë kanë qenë përpara 2014-s. Qoftë... Flas për Durrësin, pra, që janë bashkuar 5 institucione të mëdha apo ish-bashki me një numër popullsie të konsiderueshëm, siç ka qenë, siç është Sukthi, Manza, Ishmi, Rashbulli dhe Katundiri. Mendojmë që ne kemi bërë maksimumin, sigurisht duke pasur dhe buxhetin e duhur edhe burimet njerëzore të duhura për të dhënë shërbime në terren. Mendojmë që situata është më mirë sot sesa ka qenë para 10 vjetësh. Qoftë sot kemi territore më të pastra, kemi shërbime më të lehta që mund të jepen në njësi për qytetarët. Kemi më shumë funksione të cilat, si ai që është nishëm, si ai që është në qytetin e Durrësit, pra brenda në qytet, arrijnë t'i marrin nëpërmjet shërbimeve që jepen në njësi administrative apo edhe në bashki. Pra, ka aksesin, sepse mund të flasim në qoftë se i rikthehemi këtyre ish-bashkive përpara vitit 2015, apo para se të ishin pjesë e bashkisë së Durrësit, le të themi. Në asnjë nga këto njësi, që janë njësitë e Durrësit sot, por që kanë qenë ish-bashki, nuk ka pasur qendra që jepnin shërbime sociale për gratë e dhënuara, për familjen, për fëmijët. Sot ne kemi jo vetëm qendra në qytet, por dhe dy qendra në njësitë administrative, ku qytetari që jeton në Ishëm shkon pranë njësisë administrative dhe merr këtë shërbim sot. Dhe në qoftë se do më të specializuar, afrohet edhe më shumë drejt qytetit. Ndërkohë, ka munguar më herët e kështu me radhë dhe shërbime të tjera, të cilat mendojmë që sot jepen më mirë sesa përpara 10 vjetësh. Faleminderit.

Luçiano Boçi:

Po, zoti Dule, fjala për ju.

Emiriana Sako:

Ishte për të tre.

Luçiano Boçi:

Po, po, po, po, mund, ke drejtë. Atëherë, zoti Arbana, fjala për ju.

Elton Arbana:

Të nderuar bashkëkryetar, të nderuar anëtarë të Komisionit të Reformës Territoriale. Në fakt, përpara sesa t'ju përgjigjem dy pyetjeve të zotit Axhinas, unë do të doja të bëja një vlerësim për reformën e parë territoriale. Në vitin... Vlerësimi im në aspektin e reformës territoriale, që t'i përgjigjem dy pyetjeve, sepse aty do të dalë kjo pyetje e juaja. Megjithatë, më lejoni të them që reforma territoriale një ka qenë e duhura për sa i takon bashkisë së Shijakut, sepse vetëm me mbledhjen e taksave, nëse i referohemi njësive administrative, u mblidhnin për çdo njësi administrative, pra për atë që është më e madhja, në fakt, njësi administrative xhavzote, rreth 8000 lekë të reja në mijë. Dhe po t'i referohemi sot, pra bashkitë e tjera që kanë ato njësitë administrative të tjera që kanë qenë më të vogla, ishte sa gjysma e këtyre, dhe po t'i referohemi sot bashkisë së madhe, mbledhin tre herë më shumë të ardhura. Mbledhja më shumë e të ardhurave do të thotë që edhe menaxhimi është më i mirë. Dhe për dalë kjo pyetje juaj që a ka probleme bashkia e Shijakut me burimet njerëzore? Sigurisht që ka patur probleme në mbajtjen e personelit përpara unifikimit të pagave, sepse personeli në bashkinë e Shijakut, por jo vetëm, në të gjithë bashkitë e Shqipërisë, nuk ka qenë e unifikuar paga dhe për rrjedhojë ka patur shumë probleme për t'i mbajtur specialistët në bashkinë e Shijakut. Sepse, më thënë të drejtën, bashkia e Durrësit ka qenë afër, bashkia e Tiranës është afër dhe fare mirë mund të ishin tek bashkia e Durrësit specialistët, apo dhe tek ajo e Tiranës. Por, falë qeverisë, me unifikimin e pagave, të gjithë specialistët paguan njësoj në të gjithë Shqipërinë dhe kjo ka bërë që ta kemi akoma më të lehtë mbajtjen e këtyre specialistëve në bashkinë e Shijakut. Për sa i takon madhësisë së bashkisë, a ndikon tek qytetarët? Është rasti më i mirë për të parë bashkinë e Shijakut që me këtë madhësi që ka, me këto njësi administrative që ka, ia ka dalë mbanë në kohën e Tërmetit që të jetë bashkia e parë që të ketë mbaruar rindërtimin. Pra, brenda dy viteve, në vitin 2021, ne kemi bërë demolimin e 31 pallateve, 802 banesave individuale dhe 10 kopshte dhe shkolla. Dhe brenda 2021-shit, të gjithë familjet që kishin humbur një banesë për shkak të Tërmetit, kanë qenë përfitues dhe kanë marrë çelësat të një banese më të fortë, më të sigurt, më të re dhe mbi të gjitha, falas. Kush e kërkoi? Kush e bëri pyetjen? Apo kush po ja përgjigjet? S'kuptova. Atëherë, po të jesh i vëmendshëm, mund ta shohësh se kush e bëri pyetjen. Madhësia e bashkisë ndikon tek qytetarët. Unë e di që bëhesh keq kur përmenden gjërat që realisht janë për t'u përmendur. Më fal se mos mendoni që po flisni me nivel në rrugë. Je i vogël, të shohë, as nuk po të ofendoj asgjë. Pra, merr përgjigje.

Luçiano Boçi:

Zoti Arbana, tani ka një gjë, ky është komision parlamentar, je thirrur nga deputetët të mos përdorin sinuada të tilla.

Elton Arbana:

Po dakord, por je i vogël, ç'do të thotë je i vogël? Madhësia e bashkisë që unë drejtoj.

Luçiano Boçi:

Ajo erdhi si pasojë edhe e zhvillimit të replikës midis jush dhe nuk ta thanë në situatë bosh dhe ti t'i përgjigjeshe apo t'i jepje atë përcaktim të tillë, domethënë.

Luçiano Boçi:

Domethënë, jo më të lodhur jemi ne nga 11-ta deri tani sesa ju që keni ardhur dhe keni.

Elton Arbana:

A ndikon madhësia e bashkisë së Shijakut tek qytetarët? Po i thoja që siç është bashkia e Shijakut dhe siç e kemi performancën dhe që e kemi treguar.

Luçiano Boçi:

Nuk ndërhyra tek cilësia e përgjigjes tënde, ndërhyra tek reagimi dhe nuk.

Elton Arbana:

E kam shkollimin e duhur me të gjitha për t'u përgjigjur në mënyrë të duhur.

Luçiano Boçi:

Paske qejf polemikën dhe njëherë këtu në komision nuk mund t'i drejtohesh t'i deputetëve me cilësime. Është shumë e rëndë. Do të jenë në parlament këtu.

Elton Arbana:

Po ç'do të thotë je i vogël?

Luçiano Boçi:

Po tani ai s't'u drejtua kot, erdhe ti dhe tha ti që ke i vogël, të tjerët janë të mëdhenj. Tani mos e bën.

Luçiano Boçi:

Shkëput nga konteksti ti dhe më tha je i vogël. Edhe po tani ishin vazhdimësi të replikës.

Luçiano Boçi:

Tani mirë, dakord, dakord se po e bëjmë bashkë. Tani edhe ti s'mund t'i thojë kush po përgjigjet këtu me që dhe me kë unë po përgjigjem.

Elton Arbana:

Kush e bëri pyetjen, tha?

Luçiano Boçi:

Mirëpo, tani nuk u bë kjo pyetje. Kush e bëri këtë pyetje? Tha se nuk është bërë dhe ka drejtë ta bëjë një gjë të tillë. Ti thu kush po përgjigjet. I lëmë këto ndërhyrjet, cinizmat, gjërat e vogla dhe pastaj avancohet edhe në gjuhë të agravuar. Por mos harroj, janë komision parlamentar. Tani ka ca rregulla që respektohen, do s'do. Faleminderit, vazhdo.

Elton Arbana:

Atëherë, ajo që po thoja për ta vazhduar mendimet, se nuk do zgjatem shumë, madhësia e bashkisë ndikon tek qytetarët. Po thoja që ne kemi performuar mirë, të paktën në këto 5-6 vite dhe e kemi treguar dhe në kohën e Tërmetit dhe në kohën e pandemisë dhe në kohën e përmytjeve dhe në gjithçka tjetër që ka patur emergjencë në bashkinë e Shijakut. Faleminderit.

Bashkia Krujë:

Përshëndetje të gjithëve, të nderuar bashkëkryetar, të nderuar anëtarë të komisionit. Për t'iu përgjigjur pyetjes së parë, cilësia e shërbimeve dhe madhësia e bashkisë ndikon në cilësinë e shërbimeve, apo jo? Atëherë, bashkia e Krujës është e formuar nga gjashtë njësi administrative: Njësi administrative Krujë, Njësi administrative Fushë Krujë, Nikël, Bupsh, Cudhi edhe Thuman. Në bashkia Krujë ka një cilësi, ka një specifikë të veçantë, sepse ka brenda saj dy qytete të cilat janë të karaktereve të ndryshme. Kruja është qytet historik dhe turistik, ndërkohë që Fushë Kruja është një qytet ekonomik dhe industrial. Dhe duke pasur këto lloj specifike, bashkia ka pasur vizionin të shpërndajë shërbimet e duhura edhe në njësinë administrative Krujë, edhe në njësinë administrative Fushë Krujë, ku në njësinë administrative Fushë Krujë janë, është drejtoria e taksave, është drejtoria e pronave, janë drejtori të ndryshme për t'iu ofruar bizneseve dhe qytetarëve shërbimin sa më afër vendit ku ushtrojnë aktivitetin. Ndërkohë që në Krujë janë drejtoritë e tjera: drejtoria e burimeve njerëzore, financa, prokurimet, urbanistika etj. Për sa i përket cilësisë së shërbimeve, normalisht që cilësia e shërbimeve është përmirësuar, për shkak sepse njësitë administrative më parë nuk kanë pasur mundësi. Okej, nëse... Ndërkohë që për pjesën e burimeve njerëzore, nëse kemi vështirësi apo nuk kemi vështirësi në tërheqjen e burimeve njerëzore, me nivelin e pagave që është, mund të themi që niveli i pagave është i kënaqshëm. Por ndërsa për profesione të ndryshme, normalisht që kemi vështirësi, siç janë inxhinierët, inxhinierët e ndërtimit, inxhinieri mekanik, nuk është aq e kollajshme që të gjinden burime njerëzore që të ofrohen me pagat që janë, për shkak sepse edhe vetë afërsia e Krujës me Tiranën tentojnë edhe drejt tregut privat, ku mund të paguhen më mirë.

Luçiano Boçi:

Një koment.

Edmond Haxhinasto:

Komenti është që, të nderuarit kryetar, kryetare dhe kryetar, më konfirmuan atë që unë e kam bindjen dhe e thashë edhe në ndërhyrjen time që çështja e burimeve njerëzore në stafet e bashkive është një problem i përgjithshëm, pavarësisht nga niveli i pagave. Sigurisht, bashkitë e vogla e kanë më të vështirë, sepse niveli i pagave të tyre është më i ulët. Dhe tjetra është që nuk ka një korrelacion, askush nuk ofron një korrelacion të drejtpërdrejtë që madhësia e bashkisë është domosdoshmërisht përcaktuese në cilësinë e shërbimeve ndaj qytetarëve. Këto janë dy konkluzione shumë të rëndësishme që mund t'iu nxjerr nga pyetjet e kryetarëve të nderuar të qarkut të Durrësit. Faleminderit.

Luçiano Boçi:

Po, faleminderit. Atëherë, fjala për zonjën Spahiu, megjithëse tek letra e lexoi Budini, shpresoj të mos bëjmë gabime.

Znj. Spahiu:

Shumë faleminderit. Së pari, do ta nis me një vlerësim për komisionin edhe për dy bashkëkryetarët, sepse për hir të vërtetës, rrallë ndodh që të kemi procese të tilla dhe uroj dhe shpresoj që procese të tilla, reforma të tilla, të vazhdojnë me të njëjtin ritëm, duke parë një bashkëpunim të opozitës me mazhorancën. Është e vërtetë, zoti kryetar, që nuk është emri im, sepse unë nuk jam as anëtare e komisionit dhe as anëtare zëvendësuese, por besoj që s'ka nevojë për ironi ose përse ne njihemi dhe ju e dini se kush është emri

dhe mbiemri im. Megjithatë, do ta konsideroja kështu si një gjë të rastit për të mos i dhënë rëndësinë e duhur emrit, nëse ju jeni dakord me mua.

Luçiano Boçi:

Unë jam shumë dakord, zonja Spahiu. E kisha me shumë dashamirësi.

Znj. Spahiu:

Faleminderit. Shumë faleminderit për procedurë. S'ka rëndësi.

Luçiano Boçi:

Meqënëse bëre një parashtrim që ty të vjen mirë që na sheh bashkë, që po bashkëpunojmë për reformën. Në fakt, ne jemi me qytetarët se ata na kanë sjellë këtu. Të mos i ngatërrojmë gjërat, sepse hidhet kjo tezë edhe për konsum paksa publik. Ne kemi qartazi pozicionet tona në raport edhe me reformën, në raport edhe me çështje të tjera politike dhe domosdoshmërisht kur bëhet fjala për qytetarët, serioziteti ynë është maksimal. Madje, e kemi dëshmuar dhe përgjatë kësaj dëgjese, sepse që kur ka nisur nga ora 11:00 deri tani, grupi që ka bërë korumin e mbledhjes ka qenë në opozitë. Ja ku i ke, kanë qenë edhe më shumë anëtarë, ndërsa grupi i mazhorancës është në minimalen e pjesëmarrjes. Dhe jo, dua të theksoj këtë, është çështje e seriozitetit të dëgjesave dhe të punës së këtij komisioni, se shpesh na e evidentoni edhe atje në seancë çështjen e votimit. Ja ku e keni sot, edhe unë shpresoja që ju do bëshit një reagim të tillë, ose ndoshta e keni në planin tuaj për ta bërë një reagim të tillë, po s'e patët, nuk ka rëndësi. Por qartazi, ne kemi pozicionet tona dhe nuk duhet, domethënë, të japim definicione të tilla politike që nuk janë të përputhshme me realitetin politik. Kemi qëndrime shumë, domethënë, diverse, të kundërta. Po, duam, po duam konsensus. Shumë mirë që e ka e gjykuar nga ana juaj me kaq pozitivitet, e vlerësoj, por ajo që duam ne është rezultati konsensual. Nuk kemi nevojë për fuçe si vazhdon, po e them figurativisht, pa përdorur ndonjë cinizëm, se çdo fjalë këtu merret për cinizëm. Duam në fund fare, përfundim konsensual. Kërkesa jonë, kërkesa juaj, në shërbim të qytetarëve. Këto zbulimet, gjërat pastaj, hajt t'i themi në deklarata në televizione. Këtu të jemi shumë seriozë dhe serioziteti në radhë të parë dëshmohet këtu, dëshmohet tek përgjigjet, tek pyetjet, tek angazhimi i deputetëve që flasin po me pasion 45 minuta, fjalë e vërtetë. Flasin edhe më gjatë, parashtrojnë pyetje dhe, dhe, dhe, dhe po, dhe në fund fare duam rezultat. Duam rezultat, rezultat që të konsiderohet mendimi i opozitës. Jo hajt se po e fusim opozitën në proces, ne po e shfrytëzojmë dhe pak për këtë pjesën e PR-it dhe në fund fare jemi ne me variantin tonë se kemi vota në parlament. Jo, nuk bëhet kështu, nuk ndodh kështu. S'duhet të ndodhë në këtë lloj forme, dakord?

Arbjan Mazniku:

Zoti Dulqin Miçi, e bëmë këtë pjesën dhe e ndërpreu nënkryetarin, e cila së pari duhet t'i falënderoj për pjesëmarrjen, siç është dhe pjesë e rregulloreve të Kuvendit, komisionet janë të hapura për të gjithë deputetët dhe e vlerësoj jashtë mase prezencën tuaj në këtë pjesë të takimit, edhe elementin e faktit që mazhoranca në mënyrë sistematike në këtë komision i ka dhënë të gjitha, të gjitha shenjat dhe elementët e mundshëm për të arritur një marrëveshje dhe për të gjetur një mekanizëm që të kuptohemi dhe të merremi vesh dhe të bëjmë një reformë konsensuale, por konsensusi është për t'u gjetur.

Znj. Spahiu:

Mund të vazhdoj me pyetjen tjetër? Faleminderit, shumë faleminderit. Pyetja është në fakt për të tre përfaqësuesit, nisur edhe nga eksperiencia juaj si drejtues të pushtetit vendor, edhe nga ankesat që ju keni nga qytetarët, nga takimet që keni. Çfarë mendoni, çfarë shërbimesh mendoni që mund t'ju kalojnë, pra shërbime të cilat merren nga pushteti qendror, mund të jenë në varësi të pushtetit lokal, për të patur një reagim më të shpejtë ndaj kërkesave të qytetarëve? Pyetja është për të tre, kështu që kushdo nga kryetarët mund të.

Emiriana Sako:

Faleminderit. Mendojmë që sigurisht mund të ketë disa funksione të cilat sot ne nuk i kemi, por që bashkitë kanë kapacitet për t'i realizuar ato dhe kjo vjen kryesisht edhe nga një. Nga takimet e vazhdueshme që ne kemi me qytetarët që vijnë çdo ditë në dyert e bashkisë apo i takon kudo në terren dhe ata përcjellin shqetësime që shpeshherë mundet edhe t'i jemi të detyruar t'i përgjigjemi që, okej, do interesohem, po këtë gjë nuk e bëj unë. Një ndër to, në këndvështrimin tim, është procesi i legalizimit. Është një proces shumë i rëndësishëm, kompleks, një proces i cili ka marrë një kohë të gjatë për t'u realizuar. Është bërë një punë e caktuar, patjetër, nga institucionet përkatëse, por ashtu siç ne trajtojmë dhënien e lejeve të ndërtimit, ato objekte janë në territorin tonë, duke i ndarë patjetër nga të gjitha çështjet e pronës. Mendojmë që në vetvete dhënia e legalizimit i objekteve, dhënia e certifikatës mund të trajtohet ashtu siç trajtohen dhe lejet e ndërtimit, po edhe pse jo, dhe në zona të caktuara ku, si me thënë, ka densitet të këtyre zonave informale, mund të merren si zona pilot. Ne kemi filluar një, e them këtë sepse ne kemi filluar një projekt me qeverinë ku bashkitë kanë vendosur kapacitete burimi njerëzor, kanë transferuar pagat dhe në rastin e Durrësit ne kemi çuar rreth 15 persona ekspertë të cilët paguhen nga Bashkia e Durrësit dhe punojnë për drejtorinë e ASHK-së së Durrësit, por mendoj që ky proces do të ishte më i thjeshtë në qoftë se e ndjekin bashkitë. Gjithashtu, një element tjetër i rëndësishëm nga eksperiencia që kemi fituar tashmë me arsimin parashkollor, mendoj që edhe tek arsimi fillor apo arsimi nëntëvjeçar ne kemi funksionin e infrastrukturës vetëm dhe sigurisht çdo dëm apo çdo nevojë që ka infrastruktura është kompetencë e bashkisë, është e shpëputur nga ministria. Ministria ka kurrikulat, ka mësuesët, ka drejtorët e shkollave. Ndërkohë, mendojmë që ky proces tashmë me eksperiencën që kemi fituar me menaxhimin e kopshteve, të cilët dhe ato funksionojnë nëpërmjet një sistemi portali, mundet të menaxhojmë edhe arsimin e nëntëvjeçar dhe të mesëm për të marrë jo vetëm funksionin e godinave, por edhe përmbajtjen, duke përfshirë kurrikulat. E them këtë mbase kjo mund të rrisë edhe pak ndërgjegjësimin sa i takon drejtorëve të shkollave apo nesër pasnese mund të vendosen dhe menaxherë për të mbajtur këto shkolla, në mënyrë që mos të dëmtohen, të ruhen dhe të kenë një cilësi shërbimi edhe më të mirë sesa mund t'i kenë sot. Këto janë dy çështje të cilat i kemi hasur në punën e përditshme dhe mundet të mendoj që ka vend për t'u diskutuar në këtë fazë që ndodhet procesi.

Elton Arbana:

Atëherë, shumë faleminderit për pyetjen. Në fakt, unë s'duhet t'u mbivendosja për fjalët që tha dhe kryetarja, sepse mendoj që edhe Bashkia e Shijakut ka po të njëjtat probleme. Pra, mendoj që hipoteka dhe legalizimet duhet të jenë në varësi të bashkive, kjo dhe për vetë faktin që ka kaluar një kohë mjaft e madhe për procesin e legalizimeve, ku Bashkia e Shijakut ka, pra, për të gjithë aplikantët që kishin ndër vite që kishin aplikuar, pra, që nga 2008-2009 dhe që sot akoma nuk, shumë prej tyre akoma nuk zënë një certifikatë pronësie, falë iniciativave të reja të qeverisë që angazhoi dhe bashkitë për të bërë dosjen e secilit aplikant. Bashkia e Shijakut i ka dorëzuar të gjitha, por po ta kishim ne drejtorinë

e legalizimeve të instaluar pranë Bashkisë së Shijakut, mendoj që do ta kishim kryer procesin shumë më shpejt, sepse edhe ankesa e qytetarëve, pra, në punën tonë të përditshme, në 80% të rasteve janë hipotekat dhe legalizimet. Kemi patur një bashkëpunim shumë të mirë ndërinstytucional dhe me institucionet qendrore për hir të së vërtetës që këto gjëra që kanë ankesa qytetarët ne i kemi zgjidhur me institucionet qendrore, por do të ishte shumë më e mirë dhe e udhës që të ishin ta dashur pranë institucionit të bashkisë.

Luçiano Boçi:

Po, është kryetarja që do japë përgjigje dhe pas. Jo, se ishte për të tre pyetje. S'ka gjë.

Bashkia Krujë:

Nuk ka gjë. Nëse humbet koha, jo, të njëjtën gjë do të thosha edhe unë. Pavarësisht se kjo varet edhe nga kapacitetet që ka çdo bashki, legalizimet do të ishte mirë që të bëheshin në bashki, por varet nga kapacitetet që kanë bashkitë. Ndërkohë që qytetarët, është e vërtetë që përplasen çdo ditë për të gjitha problematikat e tyre, përplasen tek bashkitë, duke filluar që nga elektriku, shëndetësia, arsimiti dhe çdo gjë. Ndërkohë që, ashtu siç e tha dhe zonja Imerjana, edhe arsimiti do të ishte mirë përderisa mbahet mirëmbajtja dhe do të ngrihej ndërgjegjësimiti i vetë shkollave për vazhdimësinë e procesit mësimor, sikur të vareshin nga bashkitë, përveç kurrikulave dhe ne i kryejmë funksionet tona. Mendoj që jemi ok dhe faleminderit.

Luçiano Boçi:

Faleminderit. Zoti Mziu, fjala për ju.

Xhelal Mziu:

Faleminderit. Kryetar.

Xhelal Mziu:

Unë në fakt kisha disa pyetje për.

Luçiano Boçi:

Nuk më mbajtas edhe nuk, prandaj nuk më shkon. E kam djalhtas tendencën gjithmonë edhe.

Xhelal Mziu:

Në këtë, në këtë komision, ne gjatë dëgjësave që bëjmë me grupe interesi, natyrisht edhe me drejtuesit e bashkive, tentojmë për të konstatuar kush janë problemet të cilat nuk shkojnë dhe për t'i adresuar në përfundim të këtij komisioni zgjidhjen e këtyre problemeve të cilat ta përfaqësojnë standardin e funksionit të pushtetit vendor si vendet e Bashkimit Evropian, atje ku dhe aderojmë për të shkuar në një kohë sa më të shpejtë. Nëse bëjmë krahasime nga viti 2015 dhe në vazhdim, shohim që ka probleme të cilat kanë ardhur edhe për shkak të cungimit të numrit të bashkive e për pasojë ka sjellur efekte negative. Efekti ka qenë negativ në kompleks për atë se çfarë kanë nevojë qytetarët, bie fjala, kanë nevojë për të patur më shumë investime, kanë nevojë për të patur më shumë shërbime, sepse ky është produkti të cilin ato duhet të marrin. Sfidë është vetëm një, decentralizimi është sfidë e Evropiane, absolutisht, dhe e Shqipërisë. Është bërë për mua një hap mbrapsht

në aspektin e reformës territoriale, sepse e ka larguar absolutisht shumë larg, po themi, shërbimin e qytetarëve. Imagjino, po marr vetëm Bashkinë e Krujës, një qytetar që është në Cullë dhe një qytetar që është në Thumanë e një tjetër që është në Tapiz, se sa larg e kanë mundësinë e marrjes së shërbimit, ku do t'i mund të ishte shumë oportune për të patur një bashki, bie fjala, siç është Fushë-Kruja, sepse nëse ne para reformës kemi patur 65 bashki, një ndër ato bashki që është sakrifikuar është, bie fjala, dhe Fushë-Kruja, që do të kishte qenë më oportune, do të kishte qenë më afër qytetarëve. Së dyti, kauza për të cilën unë ngrit për të patur atë ekonominë e shkallës, pavarësisht se shkonte në sensin negativ, nuk ka patur një standard, bie fjala, po merrem me Bashkinë e Durrësit. Bashkia e Durrësit është pothuajse një ndër bashkitë rekord të shpenzimeve për pagat e sigurimeve shoqërore. Kujtoj që rreth 48% e fondit të bashkisë ose buxhetit të bashkisë shkon për pagat e sigurimeve shoqërore dhe ka një regres, nëse ne e krahasojmë, po themi, me periudhën e kaluar, ose duke iu referuar, po themi, të dhënave statistikore. Po jap vetëm një shembull: Bashkia e Durrësit në vitin 2015 krijonte të ardhura të veta 7,333 lekë për banor. Në vitin 2022, sepse nuk e kam 2023-in, 2024-in, e ka ndërprerë qeveria këtë aplikimin e buletinit, kalon nga 7,333 lekë, kalon në 3,150 lekë, pra më pak sesa 50% ose diku tek 45% e atyre të ardhurave. Pra, çfarë do të thotë që nuk ka më një fokus për të mbledhur, po themi, të ardhurat e bashkisë dhe resurset të cilat ka bashkia. Së dyti, shohim që ka një rritje të administratës në të treja njësitet vendore dhe po të shohësh, në të treja këto njësitet vendore kemi trefishim të fondit të pagave në Durrës dhe në Shijak, kemi katërfishim në Krujë. Natyrisht, kjo vjen edhe për shkak të rritjes së nivelit të pagave, por edhe për shkak të rritjes së administratës në të cilën ka shkuar në të kundërtën e asaj që ne pretendonim për të kursyer nga fondi i pagave. Pra, çfarë do të thotë që paratë e qytetarëve, taksapaguesve, nuk shkojnë tek qytetari, por shkojnë, po themi, për një administratë e cila nuk është, nuk e përlligj, po themi, dhe nuk është rentabël për me një numër kaq të lartë të administratës që është bërë pothuajse unike në gjithë Shqipërinë për një rritje, po themi, drastike të administratës. Një tjetër shqetësim dhe doja të pyesja dhe kryetaren, po themi, ka dublim kompetencash. A jeni dakord ju si kryetare që për një çështje të caktuar të ketë disa kompetenca? Bie fjala, ndërtimet pa leje, a nuk mund ta përballojë IMT-ja? Po sot ne kemi IKM-tën që i shkon një personi që ndërton pa leje në Durrës, i shkon IKM-tëja, i shkon edhe AZHT-ja që është bërë së fundi, i shkon dhe policia. Pra, kemi katër taksëmbledhës, nëse do ta quania, ose gjoba që i vendosin një personi duke vendosur kushte anormale. Bashkia i ka kapacitetet për ta luajtur këtë rol. Nëse bashkia apo inspektori i IMT-së nuk e luan rolin, është ligji që operon ndaj këtij personi. Pra, a jeni ju dakord me këtë dublim apo katër struktura që shkojnë? Apo të ishte vetëm IMT-ja? Së dyti, shohim që janë deleguar disa kompetenca dhe nuk janë shoqëruar mjaftueshëm me fonde financiare. Çfarë do të thotë e ka rënduar situatën e bashkive? Bie fjala, nëse kanë kaluar zjarrfikset, kanë kaluar bordi i kullimit, kanë kaluar pyjet, kanë kaluar sa të tjera që s'po më kujtohen për momentin, por nuk janë shoqëruar mjaftueshëm me fonde financiare dhe kompetencë pa delegim fondi më duket një barrë e rëndë për pushtetin vendor dhe jo pak herë ka mjaft bashki të cilat përdorin buxhetin e tyre për të financuar këto kompetenca të cilat nuk shoqërohen. A jeni ju dakord me këtë lloj situatë që është? Një tjetër element: kryeministri, një pushtet i ndarë totalisht nga pushteti vendor, ndërhyr në kompetencat e pushtetit vendor. Kush është ajo? Bie fjala, nëse dikush, një kryetar bashkie, duhet të japë deri në pesë kate, mbi pesë kate duhet të japë kryeministri. Në cilin vend ndodh kjo? Që kryeministri merr kompetencën, madje nuk lë për të bërë dhe nga këto PDV-të, duhet t'i bëjë tani AZHT-ja dhe ju heq kompetencën. A është normale kjo? Në cilin vend të rajonit apo të Bashkimit Evropian është kjo situatë? Kemi të tjera, po prapë ndërhyrje në kompetencat e pushtetit vendor. Bie fjala, kryeministri i Shqipërisë mbledh gjithë kryebashkiakët dhe thotë: "Do të shkarkoni zëvendëskryetarët e bashkive, do të shkarkoni të gjithë administratorët." Ku, në cilin vend të botës, pushteti qendror

ushtron influencën e tij mbi pushtetin vendor, dy pushtete totalisht të ndara? A jeni dakord ju me një sjellje të tillë? Se atëherë hajde, po ia lëmë kompetencën kryeministrit dhe t'i bëjë që të gjitha. Një tjetër element në të cilin do të doja jepet vetëm 1% e GDP-së. 1% ka qenë, ka kohë, madje kanë qenë dhe ca fonde që i delegoheshin, pra nuk ka lëvizur ai 1%-shi. Jemi të fundit e rajonit se nuk diskutohet, me Evropën nuk bashkohemi. A jeni mjaftueshëm ju me këtë 1%-shin? Sepse të gjitha bashkitë e vendeve të rajonit dhe përtej kësaj shkojnë diku në shifrën e 6% apo 7% të GDP-së. Ne kemi atë 1%-shin, madje jo vetëm 1%-shin, por ndërkohë nuk jepet mbështetje, po themi, për sektorë që ju kanë deleguar, madje edhe duke ju cunguar dhe ju kanë hequr dhe disa fonde të tjera ose grante konkurruese që jepeshin dhe tashmë ato fonde i kanë institucione të tjera satelite të qeverisë qendrore, pra duke ia ngushtuar atë mundësinë e dërgimit të financimit në ato vende ku duhet. Është ekstrem Bashkia e Durrësit në të gjithë Shqipërinë përse i përket ujësjellësive. Unë e kuptoj që ka një kosto shumë të lartë ujësjellësi i Durrësit, duke e marrë me pushpime në, diku andej nga Qarku i Lezhës ose më saktë andej nga Fushë-Kuqja dhe ndërkohë është një barrë e rëndë për bashkinë. Pasi kalon me 100% pushtetit vendor, pastaj i hiqet pushtetit vendor, e merr përsipër ministria, bën, po themi, një rajonalizim, tani po bën një kombëtarizim të kompetencës e për pasojë, po themi, qytetarit i është rritur tarifa, po ajo çfarë është më e keqja është që rritet tarifa dhe ndërkohë uji, jo vetëm në Durrës, por kudo është i pakonsumueshëm nga qytetarët dhe në këtë kontekst do të doja që bashkitë do të ishin më autoritare që ta kishin këtë lloj funksioni, të kishin dhe mbështetjen e nevojshme siç e kanë vendet e tjera që ju t'i garantoni një ujë që vërtetë ka një tarifë, por të jetë i konsumuar. Uji sot, pothuajse në shumicën e ujësjellësive në Shqipëri, nuk është i konsumuar përveçse përdoret për të tjera shërbime, por jo për konsum për qytetarët. Mund të kisha dhe ndonjë pyetje tjetër, por nuk po e zgjas më tej, por edhe njëherë ngul këmbë që pushteti vendor duhet të mos shihet politikisht, por të shihet për t'i krijuar mundësinë që qytetari ta ketë shërbimin më afër. Do të ishte shumë më normale, bie fjala, që në Qarkun e Durrësit të kishim edhe Bashkinë e Ishmit apo të Sukthit, apo të kishim edhe Bashkinë e Fushë-Krujës, apo të kishim edhe disa bashki të tjera të cilat do të ishin më afër qytetarëve dhe jo një qytetar të ikë nga Thumana apo nga Tapiza për të shkuar në Fushë-Krujë, apo dikush tjetër për të ikur nga Lalëzi për të shkuar në Durrës, etj., elemente të cilat është një barrë e rëndë për qytetarët dhe në fakt shkon në të kundërtën e decentralizimit. Një sfidë kjo për Bashkinë Evropiane, jo më për Shqipërinë. Faleminderit!

Bashkia Krujë:

Atëherë, nuk e di nëse juve ishit në fillim këtu apo erdhët pak me vonesë, ku unë e preka edhe pjesën e Bashkisë... njësisë administrative Krujë dhe njësisë administrative Fushë-Krujë. Kruja përbëhet nga dy qytete në territorin e saj të bashkisë, ku njëri është historik dhe turistik, ndërkohë që tjetri është... Ishit këtu? Po s'ka lidhje kryetarja e Durrësit me Fushë-Krujën? Ok, gjithsesi ne si Bashki e Kruje mendojmë që është një element që nuk duhet. Dhe për sa i përket shërbimeve që ofrohen në territor, kryesisht shërbimet sot ofrohen online dhe në njësitë administrative ka punonjës që janë punonjës taksash? Jo, jo, jo, po ka edhe punonjës që janë... Ah, ok, në rregull, dakord. Përderisa u përmendët, mendova që e kishit me mua.

Emiriana Sako:

Mirë, faleminderit deputet. Unë pak a shumë ktheva një përgjigje për çështjen e... le të themi të kompetencave të ndara edhe qëndrimin që kemi. Do të ishte më e mirë që këto... për të dhënë një shërbim më cilësor, mendojmë që këto kompetenca, të paktën në zërat që u përmendën më lart, të ndahen në mënyrë që institucionet të marrin përgjegjësitë e

tyre për zbatimin. Desha të saktësoja që përqindja e... pesha e pagave në buxhet është 30% dhe jo 46% siç e përmendët. E thashë dhe pak më herët. Pastaj, sa i takon... a duhet të jenë... domethënë, diskutimi të hartës, unë do të doja të mos t'i futesha, sepse besoj se janë ekspertë ata që do të vlerësojnë... do të vlerësojnë skenarët e ndarjes së territorit, por ne mund të themi që nga pesë njësitë që kanë qenë të gjitha ish-bashki, relativisht të mëdha si territor, ne kemi uazuar një borxh prej 3.6 milionë dollarësh, i cili është... është ezauruar gjatë këtyre 10 viteve. Ka ngelur një diferencë e ulët, për të thënë të vërtetën, sepse kjo diferencë e mbetur nuk ka pasur asnjë dokumentacion shoqërues. Ideja është që këto njësi, më përpara, aty kanë qenë dhe sigurisht që ish-kryetarët e bashkive aty, apo ish-kryetarët e komunave, apo ish-administratoret e këtyre territoreve mund të kishin bërë investimet e tyre, por ne na rezulton që, të paktën në njësitë administrative, Durrësi ka 24 orë ujë, përjashton një zonë të Manzës, i ka të gjitha shkollat, 90% të shkollave të reja të bëra që të gjitha gjatë këtij... gjatë këtij 10-vjeçari, në njësitë administrative, në njësitë... në të gjitha njësitë administrative, në të gjitha njësitë administrative, po. Kemi shërbime sociale që jepen në... në këto njësitë administrative. Më përpara kjo nuk është bërë dhe mendojmë që ky territor në këtë formë ka marrë më shumë shërbime gjatë këtij 10-vjeçari sesa më herët. Diskutimit a duhet të ishte dhe si duhet të ishte, unë personalisht nuk i futem, sepse mendoj që ka ekspertë që mund ta bëjnë më mirë se unë këtë. Faleminderit!

Elton Arbana:

Mundem unë, kryetar?

Luçiano Boçi:

Jo, zoti Mziu mund të flasë me mikrofon.

Xhelal Mziu:

Ju bëra dhe të paktën dhe dy pyetjet tjera që ja na shkaluat: së pari, dublim kompetencash midis pushtetit qendror dhe pushtetit vendor, dhe së dyti... dhe së dyti, një sekondë... me deputetin Cara dhe me mua, që mos humb kohë... Jo, më jo, po bëj pyetjen unë, sepse s'e di çfarë i ka thënë Cara, s'mund të thuaj mua për pyetjen që bëj... dhe së dyti... s'e ke të gjithë... dhe së dyti, po them, a jeni mjaftueshëm të kënaqur me aq kompetenca dhe aq delegime fondesh që jepet bashkisë në raport edhe me kompetencat? Dhe e treta, ndërhyrja e kryeministrit tek pushteti vendor për të... për të shkarkuar administratën që s'ka asnjë lloj lidhje midis pushtetit qendror dhe vendor. Këto tre pyetje doja.

Emiriana Sako:

Atëherë, sa i takon kompetencave, unë e përmenda që ne funksionet pa buxhet dhe pa financa nuk i përkthejmë dot në shërbime, që do të thotë, në qoftë se do të marrim funksione të reja, këto patjetër duhet të jenë me financa. A jemi të kënaqur? Mendojmë që është bërë një punë e madhe, ka vend për t'u përmirësuar? Patjetër që po. Pyetja tjetër ishte: a mendoni se duhet të ndërhyjë kryeministri? Ne kemi pasur disa lëvizje në strukturat e bashkisë, por ato që ju përmendët janë struktura politike, pra nuk vijnë nga nëpunës civilë dhe nuk ka asgjë të keqe që administrata herë pas here të ketë burime njerëzore të reja dhe që të japin kontributin e tyre për zhvillimin e qytetit. Pyetja tjetër ishte

për dublim kompetencave. Dublim e kompetencave, unë e thashë, e përmendi dhe deputeti Cara që në disa funksione që ne kemi, kompetenca të ndara i quajmë, jo dublim, sepse nuk e bëj dhe unë dhe ministria, po e bëjmë të ndarë si... si... si funksion. Mendojmë që ka vend që kjo reformë e re, nëse do të finalizohet, t'i ndajë në mënyrë më eksplicite dhe më të... më të qarta, duke i shoqëruar gjithmonë me financa. Pra, mendojmë që gjërat duhet të jenë të... duhet të jenë të ndara, sepse unë e ilustrova me pjesën e kanaleve të para, të dyta dhe të treta, që ne kemi në zona të caktuara këtë kompetencë, në zona të caktuara e ka ministria nëpërmjet Bordit të Kullimit dhe kjo nuk ka efektivitet dhe nuk përkthehet dot në shërbim cilësor, në rast se ne do të mbetemi skllëvër të zbatimit të atyre kompetencave të cilat ndryshojnë edhe në territor. Pra, përveçse ndryshojnë vertikalisht në strukturat e menaxhimit, kanë shpërndarje dhe të ndryshme në territor.

Ju përmendët Ujësjiellësin. Ujësjiellësi i Durrësit ka një specifikë, sepse Durrësi është një qytet në kuotën e detit dhe të gjitha burimet natyrore që ne marrim ujë dhe të gjitha pompat që furnizojmë për të furnizuar qytetin punojnë me pompa elektrike, le të themi, dhe nuk ka, përveç Krujës, besoj, nuk ka zona tjera që kanë rrjedhje natyrale.

Elton Arbana:

Mundem këtë?

Luçiano Boçi:

Po, po, mund të vazhdoni.

Elton Arbana:

Jo, meqenëse kishim 8 pyetje të bëra nga deputetët dhe 2 prej tyre na përkisnin të 3 bashkive, pra kjo e kompetencës së IMTV-së dhe IKMT-së, nisur dhe nga ligji i inspektimit, të dyja nuk bien ndesh me njëra-tjetrën, pra aty ku vepron IMTV-ja, e ka në zona të caktuara pranë njësi të vetëqeverisjes vendore, pra pranë bashkive, dhe nuk mund të hyjë dot IKMT-ja. IKMT-ja ndërhyt vetëm në rastet kur janë zona bregdetare, arkeologjike dhe zona të mbrojtura, siç janë ato zonat A, siç janë në Durrës, dhe ku kanë rastet që janë të specifikuar në ligj. Dhe nëse IMTV-ja apo IKMT-ja ka shkuar tek një subjekt dhe për shkak se ka parë një ndërtim informal dhe ka vendosur masa administrative, nuk vendos një organ tjetër, pra siç është IKMT-ja. Kurse për sa i takon rritjes së punonjësve për shkak politik dhe nuk kemi investime në Bashkinë e Shijakut, unë do të doja të thoja tabelën nga 2015 deri në 2025 për Bashkinë e Shijakut, që në vitin 2016 ka qenë 25 mijë lekë në mijë, në vitin 2016 35, në 2017 10 mijë lekë në mijë, në 2018 161 mijë, në 2019 edhe për shkak të termometrit ka qenë më e paktë 44 mijë lekë në mijë, në vitin 2020 edhe për shkak të pandemisë 73 mijë lekë në mijë, dhe kështu ka vazhduar progresive në vitin 2021 77, 86, 70, 117, viti 2025 261 nga të ardhurat e veta. Dhe kemi rritje të të ardhurave të Bashkisë së Shijakut 3.5 herë krahasuar me vitin 2015, dhe kjo është një indikator shumë i mirë për sa i takon menaxhimit të taksave, pra velenë të taksave dhe përkthimin në dobi të qytetarëve të Shijakut. Pra kemi bërë respektivisht vetëm në vitin 2025 14 kilometra rrugë, 2026 shumë shpejt fillojnë 26 kilometra rrugë, 3 fshatrat e fundit. Jo, unë jam i vetmi që nuk dua shirit, ndryshe nga... Paska vetëm diçka këtu, domethënë që ndërkohë që thatë 3 bashki, më rezulton, pra po të citoj, të lutem...

Xhelal Mziu:

I vetmi kryetar bashkie që ju thoni, nëse vjen IMT-ja, nuk vjen IKMT-ja.

Elton Arbana:

Unë përpara se të isha kryetar bashkie kam qenë drejtor IKMT-së që harkuj Durrës dhe e di shumë mirë. Atëherë nuk më the policia e shtetit, më the IMTV-ja dhe IKMT-ja.

Elton Arbana:

AZHT-ja nuk shkon në terren. Dakord. Po, AZHT-ja del në terren për të parë ligjshmërinë e leve që ka lëshuar vetë në kuadrin e taksaforcës. Ajo që po thoja për ndërtimet informale, se u referova ndërtimeve informale dhe jam shumë i kujdesshëm, për ndërtimet informale del IMTV-ja dhe IKMT-ja, se nuk del për gjë tjetër. Megjithatë, e kisha më tepër si përgjigje të pyetjes që the për 3 bashkitë, dhe një nga 3 bashkitë në qarkun e Durrësit është dhe Bashkia e Shijakut, dhe kurrsesi s'mund ta lejoja që të dilja pa përgjigje. Faleminderit.

Luçiano Boçi:

Po atëherë, zoti Elezi, fjala për ju. Doje një koment, zoti nxirrur? Një koment, jo.

Ermal Elezi:

Meqenëse u përmend edhe para, jo, tani unë do e mbaj, unë do e mbaj të paktën 45 minuta që të tregoj zellin tim. E mbaj unë, s'e kam problem. Në 2014-ën, 185 njësi administrative kishin më pak se 2% nga buxheti me të ardhurat e veta. 185 njësi administrative të sotshme, ose komuna të djeshme, na tregojnë që ka pasur një problematikë të madhe për sa i përket stabilitetit financiar të atij sistemi dhe rezultateve që ka sjellë reforma. Dhe do doja të kuptoja më mirë nga përvoja e secilit të ftuar, si ka qenë ky hendek në lidhje dhe me shërbimet përpara reformës, si paraqitet sot, sidomos midis qendrave urbane dhe shërbimeve, dhe pse u përmendën përtej atyre që jepen online, por dhe shërbimeve të tjera me zonat rurale. Dhe gjithashtu, nëse ka secili prej jush ndonjë rekomandim të vlefshëm në lidhje nëse ka kuptim rishikimi, qoftë i kompetencave të njësive administrative, por edhe i numrit që ju keni vetë të njësive tuaja administrative, pra vazhdojnë të jenë të vlefshme në këtë numër dhe në këtë lloj shërbimi, dhe kjo, ta perifraroj sepse paragjykohe mi pastaj, nuk do të thotë që të mund të zvoglohen, mund edhe të shtohen. Por nëse lind nevoja dhe keni bërë një analizë në lidhje me njësitë administrative. E përsëris, qoftë për aspektin e kompetencave, qoftë në numrin e tyre faktik të rremë. Faleminderit.

Elton Arbana:

Atëherë, shumë faleminderit, mundem? Shumë faleminderit për pyetjet. Në fakt, do ta nis nga kjo e fundit. Në Bashkinë e Shijakut do të doja të thoja që nuk do ishte e nevojshme shtimi i numrit të njësive administrative, sepse është në perfeksion, mendoj unë, edhe për vetë natyrën ku shtrihet Bashkia e Shijakut, por pse jo një rishikim të hartës territoriale, po. Sepse njësi administrative gjafëzodhe, pra po dalim në rastin konkret, vazhdon shtrirjen e saj, pastaj e lë dhe fillon Bashkia e Shijakut, dhe më pas vazhdon prapë njësi administrative gjafëzodhe. Dhe do ishte shumë e udhës që të fillonte dhe të mbaronte deri aty, dhe nëse fillon njësi administrative e Shijak, dhe ajo pastaj të vazhdonte dhe të mbaronte derisa t'u pushim prapë bashkë. Dhe këtu i referohem edhe, i referohem STAR-it Borak. Është një fshat që me ligj në vitin 2017 është komunitet, është minorancë kombëtare, pra janë të ardhur nga Bosnja, dhe ato më shumë, domethënë, janë shumë më afër Shijakut, ose jetojnë në Shijak, por çuditërisht i kap njësi administrative gjafëzodhe. Dhe unë këtë do të doja që, pse jo, t'u rregullonte nëse jemi në kohën e duhur, që atë STAR-i Borak të atyre, pse ne njohim muhaxhirëve të ardhur, t'i kapte Bashkia e

Shijakut. Sepse është dhe një kërkesë e tyre. Pra edhe ato kanë shprehur dëshirën në dëgjesat tona publike, dhe ato kanë shprehur dëshirën që të përfshihen dhe të jenë pjesë e Bashkisë së Shijakut dhe jo njësisë administrative gjafëzodhe.

Ermal Elezi:

E kisha dhe në lidhje me kompetencat. Duhet bërë, për shembull, ende prokuruese të blerjeve të vogla, ose kompetenca të tjera?

Elton Arbana:

Po, edhe për sa i takon kompetencave, personalisht unë jam këtu për të përfaqësuar Bashkinë e Shijakut dhe si i tillë flas si kryetar i Bashkisë së Shijakut, si një lider i mirë, unë që në ditën e parë kam ndarë kompetencat me nënkryetarët dhe me të tjerët, që do të thotë çfarë kryetarët e njësive administrative i kanë të gjithë kompetencat për të bërë çdo gjë. Dhe për sa i takon që a mund të bëjnë ato tenderime, nuk është çështje bisedës se a mund t'i bëjnë ata apo t'i bëjmë ne, dhe në fund të ditës edhe ato, nëse duan të jenë pjesë e kësaj gjëje, përfshihen nëpër komisione dhe janë pjesë e asaj gjëje. Pra unë kam preferuar që, nëse njësi administrative përkatëse ka kërkuar që të bëhet diçka, e kam përfshirë punonjës të njësive administrative në procedurat e prokurimit, pra që është vetë personi, e kanë iniciuar, e dinë hallin se ku është, etj., etj., dhe për t'i nehtur në kokë të gjithë kësaj gjëje.

Emiriana Sako:

Ligji 139 i 2015-s e lë në diskrecionin e njësive vendore menaxhimin e njësive administrative. Mendoj që, meqenëse ne jemi në prag të një hartimi të një reforme administrative territoriale të re, mund të ketë një kuadër ku të specifikohen apo të standardizohet disa kushte për njësitë administrative. Ndër to mund të jenë mënyra e shpërndarjes së fondeve, për shembull. E rëndësishme patjetër duhet të jetë dhe përfaqësimi politik në Këshillat Bashkiak në rastin që flasim për njësitë vendore, por dhe disa standarde minimale që duhet t'i japin këto territore për t'u klasifikuar si njësi administrative. E kuptoj që kjo mund të shihet dhe si ndërhyrje, mbase në kompetencat e njësive vendore, por standardizimi i tyre dhe vendosja e disa limiteve dhe kornizave mundet të jetë një moment që t'i rishikohen. Faleminderit.

Bashkia Krujë

Atëherë edhe ne, për sa i përket kompetencave të kryetarëve të njësive administrative, ato kanë kompetencat e domosdoshme, kanë dhe punonjësit e domosdoshëm për shërbimet që ofron çdo njësi administrative. Dhe për sa i përket shpërndarjes territoriale, shpërndarja territoriale është siç ka qenë në fillim, krijimi i Bashkisë së Krujës, një bashkim mekanik, nuk ka ndryshuar territoret e njësive administrative, përkundrazi, është, po të shikoni hartën, është një, por prapë edhe kjo i përket ekspertëve, nuk na përket neve, është dalja në det që është e munguar, e cila mund të krijohet. Dhe gjithashtu kemi, do ishte mirë që Kruja të më ndjejë, zonja Mirjana, do ishte mirë që të kalonte me qarkun e Tiranës, për shkak edhe të afërsisë territoriale, edhe për mënyrën e ofrimit të shërbimeve. Kruja gjithmonë ka qenë pranë Tiranës. Faleminderit.

Luçiano Boçi:

Faleminderit, propozimi është interesant, në fakt, do e shqyrtojmë si mundësi kur të flasim për nivelin e qarqeve dhe kompetencat e tyre. Megjithëse kalimet në njësi të tilla, qoftë

edhe ndarja dhe bashkimi, duhet të kalojnë nëpërmjet një elementi shumë të rëndësishëm që është referendumi, që shmanget në fakt nga debati ynë, që është detyrim kushtetues, jo i përcaktuar qartë në kushtetutën e Shqipërisë, por në Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore është i përcaktuar në mënyrë taksative. Lëvizjet e territoreve, ndarjet apo bashkimet e tyre në nivele të ndryshme të pushtetit vendor bëhen me referendum. Dhe ne shpresojmë që të marrim vendimin që të bëhen me referendum, se do të ishte arritja më e madhe e këtij komisioni, në qoftë se ne zbatojmë parimin referendar. Fjala për zotin Luku.

Artan Luku:

Faleminderit, bashkëkryetar. Në fakt, ky komision është krijuar, unë mendoj që ky komision është krijuar nga nevoja, dhe kur dëgjoj tendencën e drejtuesve të administratës vendore për të folur për punët e mira, duket sikur s'kemi nevojë për reformë, dhe tani më kemi kapur maksimumin, dhe ndoshta komisioni duhet të pushoi së ekzistuari, dhe punët do të vazhdojnë siç ishin. Në fakt, ne këtu nuk jemi mbledhur që ne të vejmë në vështirësi drejtuesit dhe ata të përfitojnë nga rasti për të folur për punët e tyre të mira, por ne jemi mbledhur për të nxjerrë një produkt të mirë në lidhje me reformën e ardhshme territoriale. Kështu që unë jam i detyruar të përsëris disa prej pyetjeve, të bi në përsëritje me komentet e mia të vogla, të shkurtra, më tepër tendencioze për të kuptuar qëllimin e pyetjes, që të marrin përgjigje të cilat do t'i shërbejnë këtij komisioni që të nxjerri konkluzione për reformën. Unë i kthehem në fillim të bisedës, pyetjes, në fillim të debatit. Vërtet mendoni që ndarja administrative ka funksionuar, dhe unë këtë do ta krahasoj me disa raste konkrete? Rruga e Ishmit është shembull, ka dy shembuj shumë seriozë që me datën 6 janar, dhe vazhdon të jetë një rrezik permanent për të gjithë banorët apo turistët të cilët frekuentojnë zonën e Ishmit. Është akoma e parregulluar për arsye administrative, për diçka do mblidhet Këshilli Bashkiak, në mos gabofsha, mungesë fondesh, etj., etj. Është një rrezik permanent. Në kjo reformë territoriale, po të kishte qenë Bashkia e Ishit në vete, ndoshta rruga do të kishte përfunduar, tani më do të ishte e rregulluar. Shijaku po has vështirësi të mëdha në menaxhimin e mbetjeve. Kjo si rrjedhojë e reformës territoriale? Menaxhim serioz, i cili ka vënë në vështirësi edhe juve si drejtues të njësisë administrative, por dhe vetë banorët e zonës. Kështu që nuk mund të kemi kaq perfeksion. Mendoj që ju duhet të jeni më mendjehapur kur jepni opinionin tuaj për reformën, dhe jo të flisni sikur keni ardhur këtu për të raportuar për vendin tuaj të punës.

Arbjan Mazniku:

Shkurt. Bëjmë pyetje se mendojmë çfarë duhet të mendojë ai tjetri, është gjithë shumë. Domethënë, unë mendoj që ti duhet të mendosh kështu, është shumë. Bëjmë pyetje se është dhe vonë.

Jemi të zgjuar. Opinione do kemi kohë t'i shprehim. Hajde t'i bëjmë pyetjet, të flasim njerëzit. Pra, kemi pasur një dinamikë të qetësishme këtu.

Artan Luku:

A s'e kuptova çfarë po mendonte zoti Mazdigu tani? S'e kuptova se çfarë po mendonte që po flet. Le ta mbaroj se të dibiçkoj.

Arbjan Mazniku:

Jo, patjetër, patjetër. Po, do të vlerësoja pyetjet. Me takordakord, po, të kemi harxhuar. Pyetja ime e parë ishte: si të dëgjon njeri?

Artan Luku:

Pyetja ime e parë ishte: vërtet ju mendoni që kjo reformë ka qenë e vlefshme? Unë mendoj që nuk ka qenë e vlefshme, dhe se do flasim për bashkime të mëdhaja, pa diskutim që Bashkia e Durrësit nuk do ta kalonte derdhjen e lumit Erzen, por ajo do t'i përkiste Bashkisë së Shijakut. Kështu që Shijaku në një farë forme është dëmtuar nga reforma e 2014-s, pavarësisht se zoti Arbana e mbron me forcë këtë reformë. Unë mendoj që Shijaku ka pësuar një dëm serioz duke hequr një zonë që tradicionalisht ka qenë e lidhur me qytetin e Shijakut. Shijaku herë e ka pasur qendrën në Shijak dhe herë e ka pasur në Ishëm, historinë e vet. Kështu që pyetja e dytë e imja ka të bëjë me burimet njerëzore. Do bie në përsëritje, por në një kontekst tjetër. Kur u krijuan bashkitë, kur filloi reforma territoriale, por e cila tani më po diskutohet më së shumti prapë, u tha që ne nuk kemi burime njerëzore të mjaftueshme për të pasur pushtete lokale efikente që i përgjigjen sinergjisë së Bashkimit Evropian, ose që të ndërtojnë struktura të afta për të qenë pjesë e Bashkimit Evropian. Tani na del që i paskemi struktura shumë të afta. Unë di të them kaq: Bashkia e Budvës, shumë më e vogël se Bashkia e Durrësit, ndoshta është sa Bashkia e Shijakut, dhe shumë më e vogël se Bashkia e Krujës, ka përfituar dhe ka të njëjtin pozicion gjeografik si... dhe nuk ka, nuk i ka favoret që ka Bashkia e Durrësit. Ka marrë nga fondet IPA të Adrionit 160 milionë euro. Sa ka marrë Bashkia e Durrësit, sa Shijaku, sa Kruja? Domethënë, zyrat, të gjitha vendet e rajonit, të gjitha vendet e Bashkimit Evropian dhe vendet që aderojnë për të qenë pjesë e Bashkimit Evropian, kanë punuar me burimet njerëzore dhe kanë formuar strukturat e posaçme që merren, që janë të afta të thithin fonde nga Bashkimi Evropian. Dhe nëse juve do flisnit... nëse ne do flasim këtu për burime njerëzore të arriera, duhet të kishit metodologji tani më... metoda pikëzimi. Nuk mund të flasim dot që kemi struktura të mira. Sa ishte pikëzimi? Sa ishte niveli i administratës para reformës dhe sa është niveli i pikëzimit sot, pas reformës? Sa është niveli i arsimimit që ka administrata sot? Apo kemi një administratë të mbushur me punëtorë partie, patronazhistë e kështu me radhë? Nuk ju paragjykoj, por mendoj që duhet të ishte më profesional, se po flasim këtu që kemi rritur nivelin. Pyetja ime e tretë ka të bëjë me numrin e banorëve. Kush nga ju di të më thotë sa është numri i banorëve i njërive që nuk kanë qenë më parë? Për shembull, dua të flas për njësitë administrative Ishëm, Manë, për ty Elton, Bashkia... për njësitë administrative Gjepale me radhë. Dhe nëse kemi lëvizje popullore, i kemi këto drejt qendrës së qytetit, apo i kemi ikje totale nga qarku i Durrësit, apo dhe jashtë vendit? Dhe pyetja ime e fundit... do bëj edhe një pyetje më vonë, nëse do të kemi mundësinë. Kemi një iniciativë të kryeministrit për përgatitjen e një ligji për t'i marrë disa kompetenca policisë bashkiake. Ndërkohë, në pyetjet që u bënë këtu nga zonja Spahiu dhe zoti Elezi, u kërkuan që një pushtet lokal të ketë disa kompetenca të tjera. A ju duket e drejtë kjo, po ose jo, që të merren kompetenca policisë bashkiake? Faleminderit. E para, jo në rregull. E vetmja gjë është që... pyetje hipotetike për një ligj që ndoshta po përgatitet, çfarë mendimi i kthen për një ligj që ndoshta po përgatitet, është që e vështirë mu përgjigj, se...

Arbjan Mazniku:

Ju e keni parë ligjin për kryeseditim? Kot, e keni patur ligjin?

Arbjan Mazniku:

Se në qoftë se ju s'e keni parë...

Artan Luku:

Unë po bëj një pyetje tjetër atëherë. Zoti Mazniku, do bëj një pyetje që besoj që edhe ty do të pëlqejë. A keni juve... a keni juve... a mendoni që keni kompetenca të tepërta bashkitë sot? Pushteti vendor sot ka kompetenca të tepërta dhe ndoshta ka ardhur momenti që pushteti të ndahet me shkallë? Të kemi një vizion tjetër të ndarjes së pushtetit, ku të kemi, domethënë, disa procese të jenë në një nivel tjetër, disa procese më të ulëta në një nivel tjetër. Për këtë do doja një përgjigje... do doja një përqendrim në përgjigjen e kësaj pyetje.

Elton Arbana:

Atëherë, shumë faleminderit për të gjitha pyetjet. Në fakt, nuk kemi fare në vështirësi për aq kohë sa kemi pranuar për të ardhur këtu në këtë komision, madje siç e shikoni, ka marrë dorë shumë i përgatitur për të përfaqësuar Bashkinë e Shijakut. Do e nis nga kjo e fundit, për sa i takon... a keni informacionin e duhur për njësitë administrative se sa ka qenë numri i popullsisë? Sigurisht, madje e kam pasur zyrtare. 2023-ën, 2022-shin, 29-ën, 15-ën, 16-ën, deri në 14-ën. Por që mos të... mos t'u zgjasja, do doja të thoja që në Bashkinë e Shijakut nuk kemi një numër shumë të lëvizshëm për sa i takon banorëve, qoftë në njësitë administrative, por qoftë në Bashkinë e Malit të Shijakut. E thonë ndryshe, nga 2015-ta deri në 2025-ën, në totalin e të gjithë njësive administrative kanë qenë 44 mijë... 45 mijë e 73 qytetarë. Dhe në vitin 2025, pra në dhënat e fundit, madje 2026-ën që e kam marrë zyrtarisht, me gjendjen civile janë 48 mijë e 753 banorë, që ka gjithë Bashkia e Malit të Shijakut. Ka qenë e ekuilibruar numri i banorëve në të gjithë njësitë administrative gjatë gjithë këtyre 10 viteve. Për sa i takon një pyetje që ishte për sa i takon menaxhimit të mbetjeve, atëherë unë do doja të thoja që menaxhimi i mbetjeve në Bashkinë e Shijakut nuk bëhet nga bashkia, bëhet me operator ekonomik. Domethënë, domethënë si ishte Shijaku në menaxhimin e mbetjeve, ka patur... a ka patur vështirësi, domethënë që ishte... sigurisht që ka vështirësi në të gjithë bashkitë për sa i takon menaxhimit. Dakord. Unë e mora si pyetje. Atëherë dalë te kjo tjetra, se unë mundova t'i marr në shënim të gjithë. Ke burimet njerëzore. Unë e thashë edhe më përpara që përpara unifikimit të pagave, realisht më besoni mua, që në Bashkinë e Shijakut, edhe jam shumë kompetent për këtë që flas, me zë e kemi majtur administratën. Sidomos ata që ishin profesionistë. Kjo edhe për shkak të natyrës që ndodhi në Bashkinë e Shijakut ndërmjet ditës 26 nëntor, kur ne o dashurit punonim me orare të zgjatura për të sistemuar qytetarët e Shijakut. Dhe pagat ishin shumë minimale, por ne kemi frymën e grupit, kemi edhe një slogan: "Ku ka vullnet, ka zgjidhje", që ti e din shumë mirë. Tani, sepse je nga zona jonë e Shijakut, dhe falë frymës, dhe falë sloganit, dhe falë punëve që kemi bërë dorë mbas dore me njëri-tjetrin, ne ja kemi arritur që nuk kemi parë a është ditë e shtunë, a është ditë e diel, nuk kemi parë se sa pagë marrim, por i kemi shërbyer qytetarëve të Shijakut. Me unifikimin e pagave është bërë akoma më e mirë gjëja. Pra që mundemi t'i mbajmë dhe t'i kemi. A do... a do donte më shumë pagë? A do donim ne të kishim një sistem pikëzimi më? Tani më. Po sigurisht që mbas do donim të kishim më një sistem pikëzimi. Që thonim: "Shiko se ky inxhinier nuk na e bën më punën, po na duhet një inxhinier që ka këto të dhëna." Pra, nuk besoj që jemi në sistemin e pikëzimit për sa i takon burimeve njerëzore. Sa ka marrë Bashkia e Shijakut për sa i takon fondeve të Bashkimit Evropian? Modestisht them që, përveç Bashkisë së Tiranës, e kuptohet, për vetë natyrën se si është Bashkia e Tiranës, Bashkia e Shijakut ka një zyrë projektesh nga më të mirat në Shqipëri. Dhe aty kemi katër inxhinierë që kanë 10-15 vite që punojnë, dhe falë punës së tyre, Bashkia e Shijakut, të paktën në gjashtë vite, ka thithur 2.5 milionë euro fonde. Duke filluar tek fëmijët me aftësi ndryshe, dhe shumë programe të tjera që janë bërë në bashkëpunim dhe me organizatat jofitimprurëse. Pra, kjo është një... një indikator i mirë për sa i takon Bashkisë së Shijakut. Sigurisht që jemi... duhet të bëjmë akoma më shumë, sepse për aq kohë sa

ne kërkojmë të hyjmë në Bashkimin Evropian, duhet të bëjmë akoma më shumë për sa i takon projekteve për të përthithur këto lloj fondesh. Dhe jemi tani duke bërë diçka për projektin e argjinaturës së lumit Erzen, për të përthithur fondet nga Bashkimi Evropian. Dhe jam shpresëplotë që me organizatat mund t'ia dalim, pra në bashkëpunim dhe me organizata jofitimprurëse, mund t'ia dalim që të përthithim dhe fondet për sa i takon argjinaturës së lumit Erzen. Këto janë të dhënat e Bashkisë së Shijakut.

Artan Luku:

Edhe një përgjigje për mendimin tuaj, nëse për ndarjen e kompetencave me shkallë, domethënë në gjithë këtë... në gjithë këtë diskutim që po ka reforma, kemi dhe një... njëri nga variantet e mundshme është ndarja e pushtetit me shkallë. Të paktën ne diskutojmë mes nesh. Dhe këto do jetë... cili është mendimi juaj? A ndoshta është e nevojshme që të kemi një pushtet ku delegohen disa prej shkallëve në një nivel më lart dhe disa prej shkallëve në nivel... ndoshta marrëdhëniet administrative në nivele tjera më të ulëta? Unë personalisht do të thoja që kështu siç është, siç e kemi, mendoj që funksionon shumë mirë, të paktën edhe për një dekadë tjetër, kështu siç është. A do të duhet mbas 10 viteve t'u rishikoni disa gjëra se hesht në proporcion edhe me jetën e njerëzve, me kërkesat që kanë njerëzit, me mundësitë që ka shteti dhe që kanë pushtetet vendore? Sigurisht që është për t'u parë, por për sa i takon në këtë moment që ne flasim, unë mendoj që as nuk kemi kompetenca më shumë dhe për t'i dhënë, po as nuk mendoj që na mungon një kompetencë që ne duhet ta kishim dhe për shkak ne nuk bëjmë dot punët tona të mira të përditshme.

Luçiano Boçi:

Faleminderit. Një sqarim. Po, ja, do jap një sqarim, pastaj do e marrë fjalën zonja Sako, sepse këtu u bë një referim për numrin e popullsisë nga zoti Arbana. Dhe, apo jo? Dhe thatë që popullsia sipas jush aktualisht është gati 43 mijë, 44 mijë. Dhe nuk ka pasur lëvizje. Por zoti Arbana, ju i referoheni regjistrin civil.

Elton Arbana:

Absolutisht, po.

Luçiano Boçi:

Po, jo, po prit, se s'është absolutisht. Regjistri civil përfshin personat e larguar jashtë shtetit, personat që kanë lëvizur edhe brenda Shqipërisë, me lëvizjen migratore. Ne po themi censusi, dhe censusi na jep rezultat krejt tjetër. Dhe rezultati është gjysmë për gjysmë. Pra, ç'... po, e po, kjo është e vërteta. Tani mos bëjmë spekulime, sepse na dëgjon publiku. Pra, censusi ka banorët rezidentë që janë 22 mijë ose 20 mijë në Bashkinë e Shijakut. Regjistri civil, ne e dimë, regjistrin civil e kemi 3 milionë e ca anë, po kanë ikur 4. Kanë ikur njerëzit, kanë emigruar dhe migruar. Pra, këtu po flasim për dhëna zyrtare në kuptimin e shërbimeve që ofrojmë. Ne ofrojmë, ju ofroni shërbim për 20 mijë banorë të Bashkisë së Shijakut. 20 mijë diku aty. Meqenëse s'po e godas shifrën e saktë, se duhet të hapim ato. Por ama, mos bëjmë spekulime. Regjistri civil është krejt tjetër, mos e ngatërrojmë publikun me këtë. Janë larguar njerëzit, kanë ikur, ka shpopullim, duhet ta pranojmë.

Elton Arbana:

Dakord, mundem për t'ju përgjigjur. Atëherë, nëse do i referohemi censusit që nga 2011-ta e në vazhdim, atëherë le ta marrim nga 2011-ta sipas një stateti deri në 2025-ën për Bashkinë e Shijakut. Është po i njëjti plus... më fal, pra, nëse ne i referohemi censusit të 2011-ës deri në 2024-ën, 3-shin, deri në 2023-in, do shikojmë që në Bashkinë e Shijakut sipas censusit nuk ka lëvizje të numrit të popullsisë. Po sipas censusit vetë. Jo, dakord, ajo që... ajo që doja unë të thoja është që në Bashkinë time të Shijakut sipas gjendjes civile është ky numër, por nëse ne i referohemi censusit që na kanë nxjerrë me 26 mijë e diçka, pra gati 27 mijë, atëherë... atëherë po e mbajmë që për Bashkinë e Shijakut nga fillimi i censusit deri në atë të fundit të 2023-it është në vijë lineare e drejtë. Madje me... me... me iniciativat e fundit qeveritare, me paketën e maleve, po shikojmë që një shumë qytetarë nga Shijaku, por jo vetëm, nga gjithë zonat rurale po kthehen duke investuar nëpërmjet paketës së maleve. Falë dhe investimeve që ne kemi bërë në zonat rurale, asfaltimin të çdo fshati. Pra, unë nuk kam një fshat, përveç tre që fillojnë tani: Sheteli, Eminasi, Çizmelia, që fillon për 30 ditë, nuk kam asnjë fshat më në Bashkinë e Shijakut.

Luçiano Boçi:

S'pyeta për paketën e maleve, ishte thjesht sqarim. Ngaqë jam bashkia e parë që edhe e kam bërë, edhe pse jo gjeta rastin që edhe ta thoja. Numrin e banorëve.

Elton Arbana:

Numri i banorëve, numri i banorëve është linear. Është siç ka qenë në 2011-ën, është në 2025-ën. Meqenëse do e censusin, censusin e 2011-ës, ka pasur 27 mijë e 800 banorë. Ma shiko të lutem 2023-it të fundit, nëse s'është i njëjti. Edhe njëherë, 2011-ta, 27 mijë e 861 banorë. Ndërsa... 2023-i ishte 2 mijë e 52 banorë.

Elton Arbana:

Nuk e thashë, unë thashë linear i drejtë. Dhe një herë tjetër, numri është i njëjtë dhe unë kam patur 3 fëmijë e mbërë në 5, kështu që e kam mbetur.

Luçiano Boçi:

Me jetë gjatë dhe me fat. Zoti Arbana, shumë mirë, edhe duam, sepse preke një temë që në fakt unë s'po e prekja këtu, se e kam përmendur dy herë, një herë në dëgjuesen e djeshme dhe e përmenda dhe sot. Rënia e lindshmërisë në nivel negativ dhe e ka prekur edhe Durrësin në këtë rast. Vetëm... po. Edhe Shijakun, sepse është në nivel qarqesh edhe është në total. Nuk po futem tek bashkitë, sepse është raport që ka dalë nga Instati. Dhe ndërhyrja ime ishte sipas censusit për të sqaruar që ka ulje të popullsisë për shkak Shijaku mund të jetë në nivele më të lehta sesa të tjerët, për shkak të pozicionit gjeografik ndoshta midis Tiranës dhe Durrësit dhe më shumë i ka lëvizje migratore dhe jo emigratore, por që nuk janë të barabarta, pra mos themi shifra që nuk qëndrojnë, në raport me 2011-ën. Prandaj ta solla shembullin që në 2011-ën kishim gati 28 mijë, sot kemi 22 mijë. Kemi të qartë. Mos bëjmë ndërhyrje të tjera, domethënë.

Elton Arbana:

Jo, po s'është 22 as tani, për ne do të them. Megjithatë s'ka gjë.

Luçiano Boçi:

Tani... Censi e ka dhënë, nuk e kam dhënë unë, as Partia Demokratike.

Elton Arbana:

Në 2023-ën s'është 22 Shijaku.

Arbjan Mazniku:

Mos hyjmë në këtë diskutim se do përdorim 20 numra, përse i përket atyre që mund të ketë secili mendimin e vet, por... Zonja Sako, të lutem përgjigje.

Emiriana Sako:

Po. Atëherë unë mendoj që ia vlen të përgjigjem për dy çështje. E para për rrëshqitjen e verave në zonën e rrugës së Ishmit. Do t'ju jap një sqarim. O në qoftë se nuk duhet. Po, pra, po, nuk ka lidhje me reformën. Ato kanë rrëshqitur nga shirat. Tani ne jo e ke gabim, ti duhet të marrësh të gjitha evidencat e investimeve të bëra përpara reformës dhe investimeve të bëra pas reformës. Qoftë në Ishëm, qoftë në Mancë, qoftë në gjitha njësitë e tjera. Dhe se faktet janë aty, janë kokëforta, flasin. Ke pas buxhetet e ish-bashkive apo njërive administrative përpara reformës dhe i ke investimet sot. Kështu që ajo nuk ka lidhje fare me reformën. Ajo mund të ndodhi kudo. Është një rrëshqitje prej shirave, të cilën ne do ta investojmë me Fondin Shqiptar të Zhvillimit. Kemi mbaruar projektin, kemi aplikuar për investim. Besojmë që do ta marrim shumë shpejt. Ajo që vlen që të artikulohet edhe të reflektohet edhe nga ana jonë si kryetarë, është ndarja në nivele të kompetencave, që sot është e ndarë midis bashkisë dhe qarkut, por qarqet kanë shumë pak kompetenca. Mundet që të ketë edhe shtresa të tjera, të cilat mund të bëjnë një ndërlidhje apo të japin shërbime për bashki të cilat mund të jenë më të voglat në nivel qarku, ose siç e përmendëm të gjithë më parë, që kemi mungesë kapacitetesh në sektorë të caktuar. Dhe mundet që këto njësi, qarqe po themi, apo rajone, sido që të quhen nga ekspertët, mundet të bëjnë ato lloj procesesh pune, të cilat nuk mbulohej dot nga një prej bashkive, siç mund të jetë planifikimi urban për shembull, ose siç mund të jetë ngritja e një ndërmarrje për mirëmbajtjen dhe pastrimin e territoreve të bujqësisë, pra kanaleve kulluese-vaditëse, që nuk ka nevojë pse secila nga bashkitë të ketë të bëjë investimet përkatëse, por këto mund t'i shërbejnë edhe mund t'i shërbejnë edhe bashkive reciproke që mund të jenë brenda një qarku. Mendoj që ia vlen që të kristalizohet si ide dhe mbase të shkoj pak më tej.

Bashkia Krujë:

Vlerësojmë apo nuk vlerësojmë nëse reformë ndarja e funksioneve, reforma administrative ka funksionuar apo jo? Po të mos ishte bërë reforma administrative, njësitë e vogla administrative nuk do të kishin asnjë lloj investimi, siç nuk kanë pasur edhe më parë. Ndërkohë që me ndarjen e re administrative, të gjitha njësitë administrative kanë pasur investime të ndara në mënyrë proporcionale. Gjithashtu, nuk do të kishin kapacitetet, sepse nuk mund të ngresh një drejtori urbanistike në 6 njësi administrative, ndërkohë që ke një drejtori urbanistike e cila i përmbledh të 6-ta njësitë administrative dhe krijon sistemin e zhvillimit urban. Ndërkohë që për sa i përket numrit të popullsisë, Bashkia Krujë, po t'i referohemi regjistrimit civil, ne kemi rritje të numrit të popullsisë në 2026-ën, në krahasim me 2014-ën, por po t'i referohemi censurit 2011-2023, normalisht ka ulje të numrit të popullsisë në të gjitha njësitë administrative, por censuri i 2023-it, në këndvështrimin tim, mund të mos merret edhe shumë për bazë për Bashkinë Krujë, për shkak sepse fakti i tërmetit, shumë familje janë migruar drejt Tiranës, ndërkohë që tani me shpërndarjen e të gjitha shtëpive, janë sistemuar në shtëpitë e tyre. Faleminderit.

Luçiano Boçi:

Faleminderit. Një koment, zoti Luku, nga ana jote. Për...

Artan Luku:

Atëherë, një koment i shkurtër nga ana ime. Përgjigjet e pyetjeve, në fakt, vazhdojnë të jenë sasiore dhe jo cilësore, të përqendruara për të paraqitur punët e mira, të vetat. Unë përfitoj nga rasti i komenteve të bëj dhe një pyetje tjetër, edhe kryesisht për zonjën Sako dhe zotin Arbana. Çfarë mendimi keni ju se qarkullon nëpër tryeza një ide e Bashkimit të Shijakut? Njerëz, kolegëve i kërkoj ndjesë, unë, Igli dhe Klodi, duke qenë banorë të Durrësit, jemi çikë më sensitivë në qarkun e Durrësit dhe besoj të na e falni tendencën tonë për të qenë më aktivë kur bëhet fjalë për këtë qark. I kthehem pyetjes. Çfarë mendimi keni ju për idenë që qarkullon që Durrësi të përthithi Shijakun? Është pyetje specifike, po ose jo. Sepse kështu siç paraqitet situata, duket që një sipas punëve të mira në Thojza, duket se një përthithje e Durrësit nga Shijaku do ta bënte më të lehtë menaxhimin dhe do ta ngrinin në një nivel tjetër gjithë menaxhimin rajonal. Bashkia. Unë nuk kam, unë nuk kam koment dhe... dhe nëse po, nëse po, natyrisht që s'duhet të qendër Shijaku, që ta dimë, ndonjë Durrësi-qendër po u bashkon. Dhe nëse po, si e mendoni ju modalitetin e bashkimit?

Emiriana Sako:

Unë nuk kam koment për këto komentet e tryezave. Faleminderit.

Artan Luku:

Është ide, nuk është thjesht koment, është ide. Është ide, unë po e paraqes si ide, çfarë?

Elton Arbana:

Atëherë, meqenëse më drejtove dhe mua, si kryetar i Bashkisë së Shijakut, unë do të thoja që Bashkia e Shijakut, pra Shijaku vetë, ka një histori. Tre frymëtarët e pavarësisë janë nga Shijaku. Ka një histori që falë shijakëzve, sot Tirana është kryeqytet, që priti edhe delegacionin e Lushnjës, që e mbajti dhe e strehoi për gati dy ditë në qytetin e Shijakut. Dhe punët e mira që janë bërë gjatë këtyre 6 viteve kanë treguar fare mirë që Bashkia e Shijakut është një bashki që është pranë qytetarëve, është një bashki që punon, është një bashki që ka performancë dhe nëse kriteret për breksit, për uljen apo për nxjerrjen e një bashkie ka disa kriteret, unë besoj që të gjithë ato kriteret që ju vetë i keni paraqitur, mendoj që Bashkia e Shijakut i ka në lartësinë e duhur dhe i ka treguar që nga 2019-a, të paktën, që jemi vënë në provë edhe deri sot që flasim. Kështu që mendoj që Shijaku, Durrësi dhe Kruja janë në harmoni për qarkun e Durrësit, janë fare mirë ashtu siç janë dhe reforma një ka treguar që funksionon mjaft mirë qarku i Durrësit me këto tre bashki. Mendoj unë, mendimi im personal.

Artan Luku:

Shkurt, unë mendoj që Shijaku duhet të zgjerohet, i duhet patjetër një dalje det, në qoftë se do flasim për filozofinë e zgjerimit.

Igli Cara:

Meqenëse kaluam në diskutimin e asaj që e quajmë harta territoriale dhe në fakt është, nuk është kështu siç e paraqiti zonja Sako, nuk është më vetëalvim, por është propozim konkret dhe në fakt unë dua t'ju bëj disa pyetje në mënyrën se si e mendoni në të ardhmen, se është e vërtetë që... është e vërtetë që në fakt që zonat nuk mund të krahasohet Shijaku me Durrësin apo dhe me Krujën, sepse kanë histori të ndryshme, pozicione gjeografike të ndryshme, të ardhura të ndryshme. Është gjëja më normale që nuk i bashkojnë. Në shumë drejtime janë larg dhe në këtë kontekst, pikërisht prandaj dhe opozita kërkon që të jetë në bashki akoma më të vogla dhe për këtë, në fakt, kemi dhe një propozim konkret nga zoti Mazniku, kur propozon dhe një ndarje tjetër, ku në dy nivele. Nivelin e parë, kur të jetë nivel më i gjerë, pra që të përfaqësojë një qark rreth, mos ngelim te emri, por ideja për të qenë më tepër më i gjerë dhe kjo për arsye sepse siç kemi konstatuar, zhvillimi urban i zonave, i bashkive, ndërthurja e të njëra-tjetrës, e bën të nevojshme, sepse ne në këto momente kemi nxjerrë qarkun të pavlefshëm. Për mua është një rudiment. Në këtë kontekst, duhet të pyes: jeni ju dakord që të kemi tani më dy nivele? Me propozimin që është pikërisht se ne jemi pikërisht për ndarje sa më shumë. Jeni apo jo për dy nivele? Dhe pyetja e dytë është që, në qoftë se do të themi pikërisht, ne flasim për autonominë, që do të thotë që bashkitë të kenë mundësi që të krijojnë më shumë të ardhura. Ne këtu kuptohet që konstatuam që bashkitë, pavarësisht vendeve ku janë, kanë raporte të ndryshme të të ardhurave. Durrësi nuk i ka shfrytëzuar. Unë nuk mora përgjigje, në fakt, as për numrin e turistëve, as për numrin e punonjësve, për shpenzimet, e të gjitha po nuk kanë rëndësi. Dhe pyetja është: për të vazhduar tek ajo që tha zoti Luku, po, nuk është më mirë që ndofta, meqë edhe shërbimet për zonat periferike është fakt, sado të mundoheni, thoni që janë njësoj. Nuk është njësoj, se bota ju ka vetëm një element: nuk kemi transport për të gjithë qytetarët nga Ishmi, transport publik deri në Durrës, nga Romanati deri në Durrës. Të gjitha zonat nuk kanë transport publik. Ky është fakt. Nuk i marrin shërbimet siç kanë pasur më parë, sepse edhe qendrat...

Arbjan Mazniku:

Zoti Luku, të lutem, të lutem, se është anonimi, është hera e tretë që bëjmë koment kaq shpejt, se për ne ka dhe konteksti. Pa një parahyrje, nuk mund të shkosh tek pyetja. Mirë, mund të ma lehtë ta përfundoj, se e kam harruar të shihem.

E di, pra, po u bë, domethënë, janë 5 minuta koment përherë në orën 7 pas 11 orësh rresht.

Igli Cara:

Zoti Mazniku,

Igli Cara:

Ju erdhët te Durrësi, bëtë pyetjen e Durrësit dhe ndërkohë që gjithë pjesëtarët e komisionit kemi këtu që në orën 10:00 dhe kemi lënë...

Arbjan Mazniku:

Dhe kam gjithë një gjë që e them: dëgjesa dhe më pas këtu duhet, pra, çështja është, elementi i dëgjësës është: ne bëjmë një pyetje, kemi thirrë njerëzit për të dëgjuar, jo të na dëgjojnë neve. Diskutimi që ne sot, dhe është hera e disatë që bëjmë diskutim, që neve i thërrasim kryetarët e bashkisë për t'i bërë neve, për t'i thënë opinionin tonë për gjërat.

Igli Cara:

Shumë, ke përsërit 10 herë të njëjtën fjali.

Igli Cara:

Unë e kam shumë të qartë që e them dhe e përsërit 10 herë që është pa sens, sepse më thonë të drejtën, unë nuk më... por nuk e ndjej fare punën e kohës tënde. Unë kam hall të qytetit tim dhe më thonë: në qoftë se ti s'ke kohë, ikni ju, vëlla, se vazhdojmë ne. Unë kam përshtypjen që edhe zonja Sako, edhe zoti Arbana, edhe zonja nënkryetar janë të interesuar që për qytetet tona, unë vazhdoj dhe tërë orën. Jeni lodhur, ikni. Ç'është ky muhabet? Duhet ta mbyllim shpejtë?

Arbjan Mazniku:

Jo, mo, jo, jo, jo.

Igli Cara:

Kjo është pa sens të gjithë. Dhe që të udhëheq me lehtë ta përfundoj. Unë kështu më thua, jam kanë qenë në orën 11:00.

Jo, mo, jo, s'po të them çfarë intervistë kanë qenë qytetarët.

Arbjan Mazniku:

O zotëri Çara, të lutem, sepse unë jo, jo, po s'do të them këtë, po të them që...

Arbjan Mazniku:

Po të them që në respekt të konceptit, se tashi, nëse do bëjmë këtë gjë, në respekt të konceptit të dëgjësës, dëgjesa ka një parim. Kemi thirrur disa njerëz, në respekt të njerëzve të tyre, njerëzve, të dëgjojmë ata, jo t'ju dëgjojmë juve, sepse çështja është: juve dhe si ju, një pjesë tjetër e anëtarëve të komisionit kanë qenë këtu sot dhe kanë folur nga 10 minuta, 12 minuta, 15 minuta dhe ndërkohë që kryetarëve i kemi thënë: dy minuta do flisni juve. Nuk ka logjikë dëgjese parimi. Këtë e keni përcaktuar. Unë nuk kam as për të cilën flasim.

Parimi i dëgjësës, parimi i dëgjësës ka një element cilësor. Ne bëjmë pyetje, ata përgjigjen, ndërkohë që logjika që ne të vijmë këtu dhe neve të japim mendime, ne do kemi gjithë kohën e nevojshme që ne me njëri-tjetrin, pa pasur përballë kryetarët e bashkive, të themi gjithë mendimet tona, diskutimet tona, debatet tona, logjikët tona. Por ideja që kemi thirrë kryetarët e bashkive, i kemi hequr nga puna, i kemi hequr nga qyteti vetë dhe i bëjmë leksione dhe i flasim nga 10 minuta. Unë mendoj që kështu, po çfarë mendon ti për atë që mendoj unë? Kjo çështje nuk është etike në raport me njerëzit të cilët gjithashtu si ne paguhen nga taksapaguesit e qytetit shqiptar, kanë një detyrë për të bërë dhe i kemi thirrur gjithë ditën, kanë tërë ditën sot na dëgjojnë ne. Të gjithë. Sot kemi pasur 15 kryetarë që folën.

Igli Cara:

Po ne ne nuk e bëjmë më kështu. Po s'është faji jonë. Dëgjo, ma rregullo.

Arbjan Mazniku:

Ndërkohë nëse bëjmë më një pyetje dhe të japim...

Igli Cara:

Unë thashë, po të isha në pozicionin tuaj, nuk do e ndërhyja kurrë një deputeti. Meqenëse ndërhyjnë 5 minuta, të jemi të lehtë të tjerëve, sepse më thonë dhe unë jam person i zgjedhur dhe ju nuk mund të ndërhyni mua dhe të më tregoni si dua ta bëj pyetjen. Kjo është elementare dhe është jo etike, po fare jo etike nga ana juaj të ndërhysh dhe këtu të mos ma bëj më, se ndryshe pastaj do të detyrohem të kthehem në fjalë të tjera më të rënda. Unë këtu, bashkë me ato, pavarësisht se kemi këndvështrim ndryshe politik, pavarësisht debateve që mund të kemi, kemi një interes përbashkët që për Durrësin bëjmë më të mirën. Unë e di që juve s'ju intereson se keni qarkun e Elbasanit, por unë jam i sigurt që, pavarësisht se mund të mos jenë dakord me mua, ato do më gjejnë me vëmendje, sepse diçka nga ato fjalët e mia mund t'i hyjnë në punë dhe atyre, sepse unë e thashë që në fillim të tjerë që kjo dëgjes, mbi të gjitha, duhet t'i vlejë qytetarëve të Durrësit. Kurse ju ndërhyni, keni hapur kohë sipaske këtu në orën 11:00 këtu. Kujt i vlen në Durrës kjo se jeni lodhur ju? Unë kam ardhur për Durrësin dhe nuk e ndërpres fjalën deri në fund dhe mos më prisni më, të lutem. Tani, se është pa sens, vëlla, flisni ju me minutazh, por unë kam çështje të cilat, me thënë të drejtën, kur e ngrita, jo pa qëllim e ngrita, se pavarësisht se ato nuk e thonë, por është anormale që kryeministri t'i marrë të gjithë kompetencat e tyre, pavarësisht se është kryeministri i tyre dhe unë e kuptoj pozicionin e atyre që nuk e thonë dot, se t'i marrësh lejet e ndërtimit, t'i marrësh plazhin, t'i marrësh kadastrën, t'i çosh gjithë shërbimet t'ia çosh Tiranës, po mirë, për çfarë është qyteti i Durrësit? Për çfarë është vota direkte? Se kur e thashë në fillim, nuk e thashë pa qëllim, vota direkte me emër e një përfaqësuesi lokal, se unë e kam pasur kandidate kundërshtarë, por është më e rëndësishme se një kryeministri që është me votë të deleguar, se del nga parlamenti, ajo jep llogari përpara qytetarëve dhe ju këtë të kuptoni, ndryshimin dhe ajo pastaj, normale, kur ju bëni këtë, keni dy minuta, le të flasim edhe çerek ore, se nuk përflet për çështje, flet për çështje të cilat lejnë gjurmë në të ardhmen e qytetit apo dhe të qarkut. Ju thoni që duhet t'i shkurtoni pyetjet apo dhe argumentet. Na falni se debatin këtu e kisha më tepër në kuptimin politik. Tani.

Jo, mundet, jo, jo, jo, s'të jap dot, as nuk mund të guxosh ma marrësh. Tani, unë e kam shumë të thjeshtë pyetjen, sepse ka disa parime dhe ku bëhet ndarja e zonave. Ka dhe komente të ndryshme që dikush thotë që reforma, ju keni mendimin tuaj për reformën e 2015-s, ne kemi tonën. Ne themi disa shërbime nuk janë dhënë në zonat periferike, sepse edhe ato para që ju takojnë, shpeshherë nuk i merrni dhe të gjitha, dhe ne këtu jemi pikërisht për të forcuar pushtetin lokal dhe këtu, në fakt, po të shihni të gjithë diskutimet, është në favor të pushtetit lokal, se ne këtu po flasim pikërisht për ato kompetenca që i ka marrë Rama, që është bërë kryeministër i Shqipërisë, ashtu kryebashkiak i Shqipërisë.

Igli Cara:

Dhe ne në fakt e mendojmë ndryshe, pavarësisht se dikush mund të thotë: "Ore po ju po i dini mbrojtjen e kryetarëve të Bashkisë së Partisë së Lirë", jo, ne e shohim në parim, sepse nuk do të qëndrojnë gjithmonë e njëjta situatë dhe ne mendojmë që shërbimi më i mirë është tek qytetarët kur edhe kompetencat e kryetarëve janë më të mëdha për t'i ndihmuar. Dhe në këtë sens e kisha, dhe ajo që thamë ne autonomia, po autonomi financiare, po çfarë mund t'i kërkojmë shjakut, kur shjaku nuk i ka mundësitë si Bashkia e Durrësit? Dhe me të drejtë zoti Luku tha, apo siç tha dhe zonja e Bashkisë, po mundet që

ato të funksionojnë më mirë siç ishin të ndara, Bashki Krujë dhe Bashki Fushë Krujë, mundet që të kenë dhe dalje ndezë siç e kërkoi, mundet që edhe shjaku të ketë dalje ndezë, pse jo? Sepse duhet të rrisë të ardhurat, do të ketë një performancë akoma më të mirë, sepse është gjëja më normale. Tani të më thoni që kjo nuk shkon, mua nuk më duket logjike dhe prandaj pyetja që është konkrete, ore, se një nga propozimet është që të bëhet në dy nivele, një propozim tjetër është se ka katër propozime zoti Mazniku, një tjetër është që të bëhen Bashki sa më të mëdha dhe në qoftë se do të kemi Bashki më të mëdha, të shkojmë tek pyetja që bëri kolegu, që do të kemi përthithje, të shjaku mund t'i kalojë Durrësit dhe ne duam ndihmë, se për ne është dëgjesa, ore, mirë ne mund të jemi të paragjykuar, po ju për shembull zoti Arbana, keni interes që të bëhet një Bashki e madhe dhe ta marrë Bashkia e Durrësit shjakun? Se mua më duket nonsens, edhe për historinë dhe për gjeografinë dhe për zonën që t'i kalojë Bashkia e shjakut t'i kalojë Durrësit, por propozimet janë që të rriten, jeni ju që të bëhet me votë direkte pra të kemi një kryetar qarku mbi ju për projektet që quhen urbane të zonës të qarkut të Durrësit, pra të rriten kompetencat e kryetarëve të rrethit, po e quaj si dikur, mbi ju për ato që quhen projektet më të mëdha, sepse zonja Sako tha pak më parë që kemi mungesë inxhinieri dhe unë e besoj se ndoshta nuk kanë interes dhe shpesh herë ato planet e zhvillimit nuk kemi pse t'i japim Fondit Shqiptar të Zhvillimit, por mund ta bëjë kryetari i rrethit dhe prandaj po i bëjmë këto pyetje, se duhet t'i dëgjojmë pikërisht nga ju, se ju me thënë të drejtën për disa gjëra mund të keni argumente teknike më të forta se ne dhe kur kjo keqkuptohet që ne po bëhemi me politikë, kjo pastaj nuk ka sens. Prandaj e kam shumë të thjeshtë, keni interes për këtë ndarje në dy nivele? Sepse me thënë të drejtën mund të jetë interesante, mund të bëjmë ndarje në nivelin e dytë të shumë njësive administrative, mund të bëjmë pesë jashtë dhe mund të kemi një nivel rajonal, mund të jetë dhe kjo, dhe hajde ta diskutojmë çfarë benefitesh, çfarë të mirash dhe çfarë negativitetesh kemi dhe prandaj e kisha për të treju, jeni ju për shembull Kruja e Fushë Krujës të ndahet, shjaku të rrisë çështjen e biles të ketë mundësi akoma më të errët të zgjerohet, pse jo, Durrësi, pse jo, një zonë tjetër siç quhet edhe zona ku shkon në Durrës në krahun e djathtë, të bëhet një Bashki e re, Sukthi, Katuni i Ri apo me të ketë një dalje ndezë, se ndoshta kemi dhe më tepër shërbime të mira dhe këto janë pyetjet që kemi. Tani unë e kuptoj kohën, e kuptoj edhe lodhjen, por tani këto dëgjesa kalojnë dhe pastaj bëhemi si të thuash pishman që pse nuk e thamë, pse nuk e dhamë propozimin. Zoti Kryetar, Bashkëkryetar, më mirë kuptoni, unë nuk kam folur për çështje të tjera se dua të flas për qytetin tim, pra në qoftë se marr disa minuta më tepër, kërkoi ndjesë të gjithëve, por nuk e kam as për të bërë politikë, por e kam mbi të gjitha që kur u bë 2015-ta, ne me thënë të drejtën morëm një vendim të gabuar si opozitë dhe unë e pranoj, ne nuk morëm pjesë në këtë reformë territoriale. Këtë radhë jemi seriozë siç tha zoti Boçi, po vijmë këtu, po investohemi, po japim mendimin tonë, ju mund të përdorni fortën e kartonit dhe të na i rrëzoni propozimet tona, kjo është edhe kjo pastaj është në vullnetin tuaj, por ama kemi vullnetin që të vijmë këtu të diskutojmë, prandaj edhe një ndjesë ndoshta për Tonin, por unë besoj që kjo nuk është çështje kohe, është mbi të gjitha çështje vullneti për të bërë diçka të mirë, siç dhe ju të paktën e shprehni shpesh që të bëjmë diçka të mirë në shërbim të qytetarit. Faleminderit!

Arbjan Mazniku:

Unë ti duhet të jesh shumë i sigurt për një gjë, për të gjitha çështjet që janë folur sot, për Elbasanin, për Kuksin, për Durrësin, kam opinion unë shumë herë më shumë sesa mendon ti. Në respekt të kryetarëve të Bashkive që kemi thirrë, kam rezervuar veten dhe kam kërkuar nga të gjithë anëtarët që ne sot të bëjmë atë që na takon të bëjmë si komision, të dëgjojmë njerëzit që kemi ftuar dhe të mos bëjmë politikë me dhënien e opinionëve tona dhe të dhënien e kryetarëve të Bashkive të cilët nga mjeshtri i ndarë e kanë hallin e

kryetarëve në kurriz dhe merren me zgjidhjen e kryetarëve në kurriz dhe njëherë i thërret Parlamenti i Shqipërisë për të dëgjuar dhe të përfundojnë që gjithë ditën e ditës sot, njerëz të cilët nuk merren me hall dhe njerëz për ditë si kryetarë të Bashkisë, në vend që të dëgjojnë, i thërrasin këtu për t'i dhënë leksione dhe për t'i dhënë mendime dhe ide. Tani kjo gjëja të lutem të dëgjova, o zotëri Çara, të dëgjova, të dëgjova, të dëgjova 15 minuta duke thënë çfarë deshët ju, tani do të them unë atë që thashë unë për mendimin siç e mendoj unë dhe do ta them siç e mendoj unë, por ju them prapë, sot një pjesë e madhe e njerëzve këtu kanë abuzuar me kohën e tyre dhe kanë abuzuar në mënyrë të çënësishme me kohën e kryetarëve për t'i pasur mundësi për të kryer atë që është funksioni i mirëfilltë i këtij komisioni. Sot neve nuk jemi mbledhur këtu për të thënë mendimin tonë, për çfarë mendojmë ne se si duhet të jetë njëra e tjetra, do ketë ky komision kohën për ta thënë sa herë dojë, sot detyra jonë ishte të dëgjonim kryetarët dhe gjëja që e kemi bërë është që kemi marrë dhe kemi vjedhur në mënyrë efektive, në mënyrë sistematike për arsye politike kohën e kryetarëve dhe kjo gjëja është e patolerueshme dhe është e padrejtë ndaj të gjithë kryetarëve dhe të gjithë pjesëve, sepse dhe i jam lutur në mënyrë sistematike gjatë gjithë ditës, të gjithë anëtarëve i kam thënë, hajde të bëjmë një gjë, hajde të bëjmë atë që duhet për të mirën e qytetarëve, t'i japim kohën njerëzve për të gjitha temat, nuk ka rëndësi 20 pyetje, 30 pyetje, 50 pyetje, 17 pyetje, por ama.

Artan Luku:

Dhe kryetarët dhe jeni dhe ne krahu tjetër.

Arbjan Mazniku:

Pikërisht për këtë arsye, pikërisht për këtë arsye kam vënë orar aty dhe ramë dakord dhe themi të flasim dy minuta, të flasim tre minuta, por logjika që ne këtu të flasim ne dhe t'i bëjmë leksione, kemi tërë ditën që i flasim ne, i japim leksione kryetarëve të Bashkive, ndërkohë që kjo është dita, dita duhet të ishte dita e kryetarëve, dita për atë që duan të flasim ato, ne të bëjmë pyetje, ato të na përgjigjen, ne të bëjmë pyetje, ato të na përgjigjen dhe ne kemi përfunduar, kemi folur ne, kanë folur shumica, shumica, unë mendoj kështu, unë mendoj kështu, tjetri o kënetë kaloi andej, do kemi të tërë kohën e nevojshme, ju nuk ka të bëjë me ndërprerjen, ka të bëjë me tërësinë e kohës dhe ka të bëjë dhe me një etikë normale funksionimi të këtij komisioni. Kemi folur që kur ne bëjmë dëgjesa, parimi i dëgjesës është i thjeshtë, anëtarët e komisionit bëjnë pyetje, të ftuarit në komision përgjigjen, ndërkohë që ne kemi përfunduar sot që i kemi folur ne 20 minuta, 10 minuta, 15 minuta, sot po të bëhet transkripti, në fund do bëhet transkripti, do kuptoni që kanë folur më shumë deputetët se kryetarët. Komision parlamentar do ketë, zoti Çara ju e thashë sërish dhe me këto do e mbyll këtë bisedë, se kjo është bisedë që bëhet natyrshëm, e kam thënë sërish, komisioni kur bën mbledhjet e veta për të diskutuar. Marrim tërë kohën që duam ne rrimë tre ditë po deshe ti, flasim për Durrësin, për Elbasanin, për të gjitha, si anëtar komisioni. Por kur kemi bërë dhe themi të gjithë mendimin tënd, mendimin tim, opinionin e çdo njeriu dhe marrim gjithë kohën që na duhet, rrimë pesë ditë po deshe këtu mbyllur dhe flasim nga mjeshtri i ndarë për këtë punë, është një temë të flasim neve për diskutimin tonë, është një temë tjetër ditën e dëgjesës, për respekt, ditën e dëgjesës, ditën e dëgjesës është dita që dëgjojmë ata që kemi thirrë, kjo prandaj dhe quhet dëgjesë, se ditën e dëgjesës dëgjojmë ata që kemi thirrë, kaq e thjeshtë është gjithë gjëja që po doja të thoja dhe prapë më vjen keq që neve për fiksimin e të bërit politik dhe që të dukemi mirë tek njerëzit që unë e pyeta dhe e thashë dhe e bëra këtë gjë, nuk marrim kohën që të dëgjojmë njerëzit që e kanë hallin në kurriz për ditë dhe është oportunitet i çuar dëm, kaq është thelbi.

Luçiano Boçi:

Atëherë një ndërhyrje, nuk i kemi vjedhur kohën askujt, është pjesë e detyrës funksionale dhe e kryetarëve të Bashkisë dhe e çdo përfaqësuesi në institucionet shqiptare që të vijë në Parlamentin e Shqipërisë dhe t'i përgjigjet kërkesës së tij aq më tepër në kuadrin e një iniciative siç është reforma territoriale që i shërben drejtpërdrejtë punës së kryetarëve të Bashkisë. Çdo fjalë këtu është efiçente, e duhur dhe qytetarëve i shërbejmë në mënyrë të barabartë, por në forma të ndryshme edhe ne si deputetë, se jemi të zgjedhur, e tha zoti Çara dhe ai me fjalën e tij, me punën e tij, kontaktet e tij dhe komunikimin e tij i shërbejnë qytetarëve edhe zonja Sako dhe zoti Arbana dhe përfaqësuesja e Bashkisë së Krujës dhe të tjerët që ishin në këtë dëgjese shumë të gjatë. Çështja e dëgjesës, po mo, jemi komision dhe kemi disa objektiva dhe si anëtarë komisioni ne drejtojmë pyetjet për të marrë përgjigje për të zbardhur objektivat që ka komisioni dhe ndërhyrjet në këtë rast të deputetëve janë legjitime, sepse në qoftë se unë bëj një pyetje për të synuar zbuluesën e një problematike, unë nuk mund të pranoj një përgjigje që i bie nga Kina apo nuk del në zemër të problemit dhe nuk ka as qëllim të bëjë politikë, as të performojë këtu, sepse e ka sallën e Parlamentit zoti Çara, i ka edhe në dispozicion dhe mbledhjet e tjera të komisionit. Jemi në një dëgjese që ka brenda dhe debatin, është normal, debat parlamentar është ky dhe do ketë dhe pakënaqësi, do ketë edhe ngritje zëri dhe intonacionin marrje kohe dhe marrje kohe do ketë dhe nuk duhet të keqgjykojmë njëri-tjetrin në këtë pikë. Po, duhet të rishikojmë si mund të ndërtojmë dëgjesën me më pak përfaqësues nga qarqet, me qëllim që koha të jetë më efektive, më e gjatë, të mos jemi tash në atë ngushtësinë kohore. Kështu që nuk ka nevojë fare për keqkuptime, sepse tek e fundit dëshira është ajo që në fund zoti Çara e përmbledhi në mënyrë më të qartë për publikun. Kemi çështjet e kompetencave që merren, rrëmbehen mes ditës, nuk ka reagim, ai kërkon reagim, ne duam reagim që edhe ne të jemi të qartë në atë pasqyrim ligjor që ne po e kërkojmë, po mirë, kryetarët e Bashkisë vetë e kërkojnë apo nuk e kërkojnë, por mënyrën si e ndërton ai parashtresën pyetjen është tipologjike e tij, domethënë nuk mund t'ia kurzojë as unë, as dikush tjetër, asnjë fjalë fyese nuk ishte në ligjërimin e zotit Çara, as edhe një. Parashtrim i qartë, po, i qartë, juridik me shqetësim publik, me shqetësim komunikimi, kemi kohë, humbet durimi, po, shumë e saktë edhe kjo është, humbet durimi, sepse kemi nisur që në orën 10:00 dhe në qoftë se flitet për kohë, ne kemi që në orën 10:00, nga ora 17:00 kanë përfaqësuesit e qarkut Durrës, dy orë e gjysmë kanë këtu me ne, kështu që normale më duket, po kanë folur më pak, nuk po themi që duhet të flasim më shumë, duhet të flasim në mënyrë më efektive. Po tashi, mënyrë efektive të flasim ata dhe flasim si duan, ata flasim në mënyrë efektive. Një herë në reformë thirren komisionë bashkikëshilltarë, ata atë ditë duhet të flasim më efektive, ndërkohë që anëtarët e komisionit flasim sa duan. Vazhdojmë me pyetjet, ka pyetje të tjera, ka përgjigje? Po, zonja Sako, fjala për ju.

Emiriana Sako:

Qanë këtu nuk kam një përgjigje, sigurisht në qoftë se do ketë një skenar për diferencimin në nivele të përgjegjëse, duhet që të bëhet një propozim dhe ta shikojmë të detajuar, nuk mund të flasim asi, mendoni kështu, ta bëjmë kështu, apo ta bëjmë ashtu, domethënë ne nuk jemi në pazar këtu, çdo lloj propozimi duhet.

Arbjan Mazniku:

Po tha nuk është pazar, është propozimi i kryetarit të Bashkisë.

Emiriana Sako:

Jo, jo, por të lutem, ne nuk kemi asnjë informacion, ne nuk kemi, ne nuk kemi informacion që ka.

Emiriana Sako:

Dhe këtë e dua, nuk ju ndërpreva, të lutem, në qoftë se ka propozime konkrete, unë nuk, por nuk kemi asnjë informacion, as si shoqatë, as si, po pra nuk kemi, thashë kur të vijë një prezantim i kësaj strategjie me skenar, me ekspert, jemi shumë të hapur ta dëgjojmë dhe të themi mendimin tonë, po kështu në këtë formë unë nuk kam koment.

Elton Arbana:

Në fakt unë do të doja të thoja që reforma duhet t'i shërbejë qytetarëve, për aq kohë sa ne nuk kemi një skenar se kush janë, domethënë që kemi një, dy skenare dhe kush do ishte mendimi jonë nëse do ta thoja kështu, mund t'u përgjigjesha për skenarin një apo skenarin dy, por në thelb unë mendoj që reforma duhet t'i shërbejë qytetarëve, reforma duhet të ruajë historikun e qyteteve dhe pse jo të ketë dhe kriteret në bazë të performancës dhe në bazë të gjithçkaje që Bashkitë kanë dhënë.

Bashkia Krujë:

Ndërkohë që unë nuk di që të ketë një diçka konkrete për Krujën dhe Fushë-Krujën, por Kruja dhe Fushë-Kruja e thashë dhe më parë që janë të pandara, kështu që nuk di se çfarë të them për një ndarje të tillë.

Vasil Llajo:

Me leje, zoti kryetar, ose me leje, zotëri bashkëkryetar.

Luçiano Boçi:

Ka qenë një koment, po, po, po doktor, po.

Një, a keni një pyetje doktor?

Igli Cara:

Mos më nxit në 05:00, është një minori, edhe unë po pres, atë po them, vazhdoni, unë do pres derisa të mbaroni.

Luçiano Boçi:

Ja se e mori, e do për procedurë.

Igli Cara:

Po, pres derisa të mbarosh, por nuk kam asnjë problem unë.

Aulona Bylykbashi:

Shiko, unë kam shumë respekt edhe padyshim çdo diskutim i bërë është i vlefshëm, kam vetëm një pyetje për bashkëkryetar Luçanën, nëse të gjithë ne në këtë komision vendosim të rebelohemi dhe të bëjmë diskutime jashtë rregullave, se e kam dëgjuar disa herë jemi në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, sigurisht se jemi, këtë Kuvend duhet ta respektojmë mbas rregullave që vë Kuvendi, ka disa rregulla mbi bazën e cilës

funksionojnë komisionet dhe ka disa rregulla që ne i kemi vendosur si standard për ecurinë e debatit, për kohën e debatit, për sa herë merren pyetje e kështu me radhë, kështu që do ishte shumë e ndershme që kushdo nga ne pa bërë emra në momentin që i vjen raundi për të bërë pyetje të bëjë të gjitha pyetjet në formë ezauruse dhe jo të kalojë sa herë ka dëshirë në disa raunde, sepse nëse ne të gjithë rebelohemi në këtë mënyrë i bie që koha këtu s'mbaron kurrë dhe ne nuk kemi produktin që na duhet, faleminderit.

Luçiano Boçi:

Po, faleminderit, së pari unë nuk pashë ndonjë rebelim, ishte një kërkesë për të ushtruar të drejtën e tij si anëtar i komisionit, si anëtar i komisionit dhe, dhe po, ka dhe një gjë, në qoftë se flasim për rregulla të shkruara apo të pashkruara, këtu ka diferencë shumë të madhe, sepse në asnjë gërmë të rregullores së Kuvendit nuk ka të shkruar nëse, në seancat dëgjimore deputeti duhet ta marrë fjalën vetëm një herë dhe të bëjë një set pyetjesh apo duhet ta marrë disa herë, deputeti e merr fjalën sa herë ka pyetje për të bërë dhe, dhe, dhe, dhe, po se as dëgjimore, po, dëgjimore është tani dhe një herë dhe një herë.

Vasil Llajo:

Zoti kryetar, më falni, po thatë që përgjigjet fillonin nga Kina, nga Shqipëria, nga India, unë mendoj që dhe pyetjet tuaja dhe reagimi juaj, komentet tuaja po na çojnë në Amerikën Latine, faleminderit.

Luçiano Boçi:

Doktor, shumë mirë e kape batutën edhe, por e kape keq, sepse po flasim, jo, e kape keq se po flasim për rregulla të thëna nga kolegja juaj.

Vasil Llajo:

Do të propozoja që koha e folësve të monitorohet, të hidhet në sistem, të bëhet një sondazh qytetar sa kohë folën kryetarët e bashkive dhe sa kohë folën deputetët këtu dhe unë po ju respektoj, por nuk respektoni askënd në këtë sallë veçse veten tuaj që do të dilni ju sa më të pëlqyeshëm në.

Luçiano Boçi:

Doktor, po thoni si deputet i ri i Kuvendit të Shqipërisë, sepse ka një rregull dhe keni të bëni me kryetarin e Kuvendit të afërm, e jap unë dhe zoti Mazdiku fjalën për ju, pra mos ndërhyj dhe një herë, se u fol për rregulla këtu, mos e thyej rregullin, pra këtë po thoja, të lutem mos e thyej rregullin, dakord? Tani ju merrni iniciativën dhe nuk po them që kjo është e shkruar, por ama nuk kufizohet deputeti, normal, domethënë ne vendosim një lloj modaliteti, duam t'i bëjmë sa më shpejt, sa më qartë, sa më mirë, por edhe pse ka debate nuk mund t'i cilësojmë as rebelime, asgjë.

Arbjan Mazniku:

Jo, zoti Boçi, më vjen keq, nuk jam dakord me këtë gjë dhe do ju kërkoj formalisht një mënyrë të tmerrshme dhe unë do kërkoj formalisht, në qoftë se neve nuk dakordësojmë një procedurë të mirëfilltë të shkruar me dogji të caktuar me publikun brenda komisionit, deputetët janë të pakufishëm.

Dëgjo, po ju them, po ju them sërish, në qoftë se nuk, në qoftë se ne nuk caktojmë që jo, do bëjmë debat, do bëjmë debat, do bëjmë debat patjetër, jo, do bëjmë debat patjetër, po ju them paraprakisht dhe kjo, jo, jo, dhe kjo është dhe ky është pozicioni, ky është pozicioni formal si bashkëdrejtues, ky është pozicioni.

Luçiano Boçi:

A mund të mbaroj se isha duke e mbaruar, se unë s'të ndërhyja, domethënë e mora fjalën edhe dhe në rastin konkret vërtetë mund të ketë zgjatje fjale, por ka një specifikë shumë interesante, zoti Cara dhe zoti Luku e kanë ndjeshmërinë më të lartë në këtë dëgjesë se të gjithë anëtarët e tjerë të komisionit dhe në këtë rast ka një masë etike dhe morale që ne mund t'i pranojmë që ata të flasin më gjatë edhe se mua, edhe se dikush tjetër, unë po them që ekziston, nuk po them që është e shkruar, për të shkruarën thashë, nuk e pengon njeri që ai të flasi sa dojë, kjo është e shkruara, moralia dhe etika është kjo dhe aq më tepër nuk ka as epitete, as cilësime, as thyerje, as sharje në të gjitha parashtrimet, një shqetësim qytetar dhe politik, normal me dhe politik ne jemi me kostum politik, jemi këtu ne dhe ta lejojmë njëri-tjetrit t'i shprehi qëndrimet e veta politike, nuk kufizojmë askënd, as unë s'kam ndërhyrë pse fole politikisht sa shumë, vazhdo ke kohën e do 5, 10, 15, s'ia kam përmendur askujt këtë gjë, se ndoshta kanë qenë më shkurtë, por kjo nuk do të thotë që unë jam dakord se janë më shkurtë, jo, fare, kështu që mos hyjmë, ky është debat i kotë dhe të vazhdojmë me përgjigjet apo me pyetjet, në qoftë se doktori se donte fjalën e mori.

Arbjan Mazniku:

Jo, jo, se kam për të folur më parë.

Luçiano Boçi:

Pa pjesën e dhënies nga ana jonë, mund të bëj pyetjet dhe të vazhdoj.

Arbjan Mazniku:

Zoti Boçi, kam unë për të folur përpara, po ju them formalisht si bashkëkryetar i komisionit, nuk ka për t'u bërë më dëgjesë tjetër, në qoftë se këtu nuk ka rregulla për kohën e foljes së deputetëve. Koha e foljes së deputetëve nuk mund të jetë dhe nuk do të jetë në këtë komision që bashkëdrejtohet nga unë pa afat dhe pa kohë. Neve biem dakord për një numër, sado të jetë ai numër, dy minuta, tre minuta, katër minuta dhe koha e foljes së deputetëve për pyetjet do të jetë me afat, në qoftë se nuk bie dakord për një afat, nuk do ketë më dëgjesa.

Luçiano Boçi:

Zoti Mazniku, nuk jemi në konkurse, në konkurse ne ku po s'dhej përgjigjen apo pyetjen brenda këtij afati ti s'merr pikët e duhura, tani kjo është brenda logjikës sonë të menaxhimit, është dhe individuale edhe në grup, dakord jam unë, por t'ia lëmë logjikës edhe mënyrës si ecën dëgjesa, sepse ka dhe një gjë, dëgjesa nuk mund të shkonte këtu në qoftë se përgjigjet do ishin të sakta, të përputhshme me pyetjet që u bënë edhe në seancën e parë apo në raundin e parë dhe u rimorën dhe një herë tjetër, kaq, pra ka një ndërveprim që për të cilin duhet të jemi logjikë, nuk po e bën qëllimisht zoti Cara apo zoti Luku një gjë të tillë, është dinamika e mënyrës se si erdhi dëgjesa, nuk shoh që duhet të bëjmë më shumë debat për këtë gjë, është e kotë ta vazhdojmë, sepse është një situatë që nuk ndodhi në dëgjesat e tjera, sepse morëm edhe përgjigje edhe më të sakta dhe ne

ishim më të qartë edhe nuk ndërhy më, ndodhi kjo gjë për këtë ndërveprim të munguar, tani hajde të gjejmë se ku është fajti, jo, prandaj shtohen pyetjet, se më jep një përgjigje.

Arbjan Mazniku:

Nuk po bëj fare një diskutim me panelistët, po ju them, po ju them, ju nuk po bëj as analizë, as diskutim, po ju them një pozicion zyrtar si bashkëkryetar i maxhorancës, nëse nuk biem në mbledhjen e radhës dakord për rregulla specifike për kohën e foljes, nuk do ketë më dëgjesa tjera, kjo nuk është diskutim, ky është vendim i, kështu që po nuk jam dakord, nuk ka dëgjese, kaq e thjeshtë është çështja.

Luçiano Boçi:

Ka një gjë, tani nuk po as nuk diskutoj, as nuk po them si e qysh e tek, po them rregulli do të jetë ky, nëse nuk ka, s'ka më dëgjese, mbaroi çështja.

Luçiano Boçi:

Atëherë ultimatumet publike, unë si bashkëkryetar kurrësi s'i pranoj dhe nuk i zbatoj, unë këtu jam përfaqësues i Kuvendit të Shqipërisë, jam në një komision dhe askush nuk më vendos parakushte dhe kushte, po ka bashkëpranim, po, po nuk bëhet me deklaratat dhe ultimatumet, sepse nuk bëhet, është doreza që nuk bëhet bashkëpunimi, kjo është për të mos pasur bashkëpunim, se në qoftë se do të duhesh bashkëpunim, e ndërpresim, e kemi të gjithë autoritetin, pesë minuta bisedojmë dhe mbaroj siç ndodh në të gjitha demokracitë dhe siç është komunikimi i duhur demokratik dhe njerëzor, tani me mikrofon publik më thuash mua po s'u bë kështu, kjo s'bëhet, po mos e bëni, po mos e bëni, mos e merrni këtë përgjegjësi, pra pse s'do e merrni këtë përgjegjësi, se nuk duam që deputetët flasin sipas kohës që ata mendojnë që duhet të flasin, nuk është dhe logjike, gjithsesi është në vullnetin tuaj, është në vullnetin tuaj dhe jetë.

Ultimatumet, ultimatumet, as, as jepen dhe as pranohen, as jepen dhe as pranohen, as jepen, Cara, as jepen dhe as pranohen, se është e kotë, kemi devijuar një dëgjese për gjëra, tani kushte këtu dhe ne duhet të bëjmë, pardon, dhe zoti Cara thotë, më fal se e kalova kohën unë, se tani po prishet komisioni, jo, më fare, s'ka as ultimatum, as kushte, asgjë, në qoftë se ju nuk e pranoni, vazhdojeni, bëjeni deklaratën, kjo ishte ngjarja e ditës përtej dëgjesave, shumë e gabuar për mendimin tim, se nuk ka asgjë, as zën, ja asgjë, pse u zgjat shumë, po mirëpo këtë punë e kemi bërë, ne bëjmë seancë në parlament deri në dytë natës edhe nuk kujtohet njeri dhe kushte, po kaloi koha këtu dhe sepse është e drejta, kemi, si menaxhohet koha, po mos fusni aq çështje aty, e të rrimë ne 24 orë atje në seancë, pse rrimë ne 24 orë atje pastaj, po tani mos bëjmë dhe ballafaqime tjera, e kalum, e kalum, e kaluat ju masën në këtë rast, tani a të vazhdojmë, në qoftë se ka pyetje, se duket sikur është vendosur tërësisht debati, domethënë lajmi është tjetër gjë sot dhe s'do jetë fare dëgjesa, është lajmi që PS-ja vendos, në qoftë se deputetët e PD-së flasin, se ky është problemi kryesor në Shqipëri, atëherë nuk ka komision, po mirë, në qoftë se është kjo arsye që opozitës i ndërpritet dhe një fjalë në komision që është pa kufij, s'ka kuptim.

Igli Cara:

Faleminderit, unë sinqerisht nuk besoj që ato çfarë tha zoti Mazdiku janë normale, sepse të paktën i përkasim një brezi që nuk kemi as ndikime nga e kaluara, nga regjimi i Enverit që duhet t'u bllokohet edhe fjalët deputetit, tani me mirëkuptimin tuaj ja thashë sa filloi diskutimi për Durrësin, që thashë, meqenëse nuk në diskutimet për Elbasanin dhe Kuksin

pse morëm fjalën asnjërin ne, kuptohet që për Durrësin kemi një ndjeshmëri tjetër dhe duam patjetër sqarime më të hollësishme, sepse me gjithë respektin që kam për zonjën Bylyk Bashi, unë e di që Durrësin ajo nuk e njeh siç e njoh unë me zotin Luku apo një deputet si zonja Spahiu, sepse është më se normale, tani të më thuash që për dy orë e tre çerek është e tepërt koha për të diskutuar për një qark si Durrësi. Është e tmerrshme se ne, një qark si Durrësi të thuash që është shumë pa mbushur tre orë, po, jo, po do e them përsëri, sepse përderisa vazhdoni të insistoni dhe të bëni edhe presion që nuk do të lejojmë, në qoftë se ju doni të bëni propozim për kohën ne e bëjmë, sa do të jetë diskutimi për një qark dhe pastaj e ndajmë në mënyrë të barabartë, se është qarku jonë dhe neve e bëjmë, mund ta bëni, por të na bëni presion që unë nuk do ta bëj, me të drejtë zoti Boçi thotë, po mirëpo ju mund ta bëni edhe vetë, se ju forcën e kartonit e keni, më këtë e dimë ne, po ne besojmë që ajo çfarë keni thënë që juve jeni të prirur për të bërë një reformë të mirë, unë nuk di, në qoftë se ashtu të më thonë përfaqësuesit e bashkive, nuk di të përdor një fjalë fyerëse, nuk di të kem bërë ndonjë pyetje jashtë kontekstit, kërkova një sqarim, përsa i përket pyetjes së fundit dhe këtu e mbyll zoti Mazdiku, unë bëra një pyetje që pak më parë e kishim debat së bashku, një propozim konkret të një bashkëkryetari, janë katër propozime që kanë dalë dhe në media, përfaqësuesit e bashkisë na thanë nuk kemi informacion, në fakt dua t'i besoj, por ama në qoftë se ato nuk kanë informacion për propozimet e bashkëkryetarit të tyre të maxhorancës, ky është një problem dhe unë them që ne duhet të bëjmë një seancë tjetër, të marrim propozimin tuaj dhe të na japin përgjigje, janë apo jo dakord, se është neve të grupit parlamentar, jo, nuk është, sepse është pikërisht sot, se dëgjesë unë nuk kam më, po jo, unë nuk kam më, nuk kam më me, dëgjo Alona, unë ta thashë, në qoftë se ke punë mund të vazhdosh, unë për Durrësin rri gjithë natën derisa të sqarohem, në qoftë se ato do më thonë duam ditë tjetër, unë e mbarova, ju prapë vazhdoni t'ia lëmë fjalën, unë edhe duhet ta vazhdoj, sepse janë, unë kam interes më për qytetin tim, ç'punë e keni ju? Po faleminderit, po pse ndërhyjni tek ky tre minutat e fundit, në qoftë se kam ekzagjeruar diçka më thoni, po të shih, më thoni që pse kam informacionin, shumë mirë nëse keni, po ky është, ky është propozim konkret i bashkëkryetarit tuaj dhe unë nuk e keni dakord, ndoshta e do informoni dhe mund t'ja bëjmë pastaj ose me shkrim ose një dëgjesë tjetër dhe ta thoni, jeni dakord me propozimin e bashkëkryetarit tuaj apo jo, kaq, faleminderit.

Luçiano Boçi:

Po ka një përgjigje nga zonja Sako për këtë, jo, nga përfaqësuesit e tjerë, zoti Arbana?

Elton Arbana:

Ne e dhamë përgjigjen në fakt, që reforma duhet t'i shërbejë qytetarëve, të jetë në dobi të tyre dhe kaq.

Luçiano Boçi:

Po, doktor.

Vasil Llajo:

Faleminderit zoti kryetar, nuk shtrohet çështja sa kohë do të rrimë këtu, po të donin ne mund të rrimë deri nesër në mëngjes, na bien dhe pica take away, të rrimë t'i zgjidhim dhe se Durrësi është një nga rajonet më të rëndësishme të Shqipërisë, më produktivet, me plazhet, me portet, me të gjitha, por do t'ju lutesha të fraksionojmë pyetjet dhe i jam, jo për atë që bëni ju, që do t'i shtojmë pak ujë pyetjeve tona, do t'i japim interpretimin tonë, do t'i

japim opinionin tonë dhe kur vjen puna për përgjigjen, e kërkon përgjigjen e prerë, jo, përgjigja të jetë kështu, në një kohë që përgjigja në raport me pyetjen duhet të jetë shumë më e gjerë sesa vetë pyetja, në qoftë se ne do të jemi në stilin e një, asaj të një parlamenti në të cilën nuk kufizohet marrja e fjalës, por kufizohet koha e asaj që do të thuash, se fjalët e tepërta atëherë kanë vetëm ujë, mirë do të ishte të jemi më të përqendruar me pyetjet më të sakta që do të tregojmë që ne i njohim problemet tona, kemi profesionalizëm dhe nuk jemi këtu për të rrahur kështu, ta bëjmë përsëritjen e fjalëve tona dhe kështu e shtyjmë kohën dhe pastaj themi që akuzoni që neve jemi kundër kohës tuaj, sa të doni kohën, por rrimë këtu deri nesër në mëngjes, të na shoqërojnë edhe kryetarët e bashkive dhe pse jo, janë nga personat të cilat u djeg më shumë sesa ne presojmë problemet e popullit dhe hallet e tyre dhe jo neve që shpeshherë e bëjmë edhe për efektin e kohës që të na regjistrohët koha e foljes, do të përsërisja dhe një herë që koha që u fol sot nga deputetët, le të monitorohet, të hidhet në një sondazh publik dhe të na gjykojë populli që ne e bëmë mirë këtë seancë që quhet dëgjimore, pyetësore apo një seancë për të cilën gjithmonë do të kemi të njëjtën motiv për të nxjerrur ose për të bërë politikë aty ku është edhe vetëm administrative, faleminderit.

Luçiano Boçi:

Faleminderit, unë mendoj që dëgjesa ka dhe një dimension tjetër që i ka munguar deri më tani funksionimit të pushtetit vendor që është llogaridhënia që është një nga shqetësimet kryesore, është një formë që kryetarët përgjigjen, njerëzit dëgjojnë, nuk kanë në rast tjetër t'i dëgjojnë, është shkëputur shumë kryetari i bashkisë nga qytetari dhe besoj që është në dakordësi të plotë me gjithçka që ka ndodhur këtu, ky është mendimi im, po sondazhin mund ta organizoni dhe unë vetë, doktor, mendova se do bëni pyetje, unë vetë dua të bëj dy-tre pyetje, shkurt saktë dhe qartë, po i dua përgjigjet tek e tek, shumë të thjeshta, si mendoni, cilësia e shërbimit ndaj qytetarit është e njëjtë në afërsitë të qendrës së qytetit dhe në raport me zonën rurale, e kam për të tre bashkitë, apo Çedon është më e mirë afër qendrës, në zonën urbane dhe ka probleme në zonën rurale, në qoftë se ju mendoni që është e njëjtë, na e thoni që po është e njëjtë, është cilësore, është e këtillë, këtë përgjigje pastaj do bëj dy pyetje tjera po shumë të thjeshta, konkrete, po zonja Sako.

Emiriana Sako:

Faleminderit, ne besojmë, unë besoj që pra ne punojmë që shërbimi të jetë i njëjtë, punojmë që shërbimi të jetë i njëjtë, ka vend për t'u përmirësuar, mendoj që po. Në ç'kuptim, si ta masim, domethënë në qoftë se ne do fillojmë të flasim pastaj ju na e merrni si po ju po tregojmë investime, e ke parasysh?

Luçiano Boçi:

Jo, fare, jo, unë s'kam asnjë lloj paragjykimi dhe mos e artikuloan deputetët.

Emiriana Sako:

Po e thanë, e artikuloan deputetët.

Luçiano Boçi:

Unë po jua them shumë qartë, në gjykimin tuaj ti je ajo ofruesja e shërbimit, qytetari është marrësi, qytetarët ne i pyesim në dëgjesa, po pyes ofruesin e shërbimit, ti mendon me asetet që ke, mënyrat si e ofron shërbimin, që shërbimi yt është më cilësor në zonën urbane apo në zonën rurale, apo është i njëjtë në cilësi, pra siç e merr ai qytetari se

paguajnë të njëjtën taksa, të njëjtat tarifa, a e marrin këtë shërbim në të njëjtën cilësi, ky është shqetësimi im, se dakord puna është që ta bësh sa më mirë, si është sot gjendja aktuale, si është sot?

Emiriana Sako:

Pra përgjigjja ime është që ne punojmë që të japim të njëjtin shërbim si në zonë urbane ashtu dhe në zonë rurale, cilësinë e shërbimit pastaj është ajo që duhet diskutuar, që duhet parë, duhet matur performanca, pra siç ne bëjmë performancën si bashki ka dhe drejtoritë tona që bëjnë performancën e gjithsecilit, qëllimi i reformës është që ta përmirësojë shërbimin, qëllimi i reformës është që ta përmirësojë, në qoftë se ne jemi sot këtu dhe bëjmë këtë diskutim bëhet në mënyrë që në qoftë se kemi arritur deri në një farë niveli të shkojmë akoma më lart, po është për t'u përmirësuar, ti do që të them unë sot është keq dhe ne do ta bëjmë më mirë, jo, unë mendoj që ka qenë më keq, ne kemi bërë më shumë.

Luçiano Boçi:

Zonja Sako, po insistoj shumë, pra a ka diferencë midis cilësisë së shërbimit, nuk thashë unë që është më keq apo është më mirë, diferencë midis shërbimit që ofrohet, po në dy, po sepse s'po e kupton pyetjen ndoshta ose i shmanget në formë të tillë, pra në dy zona, urbane dhe rurale, është e njëjta apo ka ndryshime, kaq, po jo, domethënë nuk dua të më japësh patjetër po jo, se jepi dhe asgjë.

Emiriana Sako:

Ju e keni fjalën që pastrohet njësoj periferia me qendrën e qytetit, shërbimi, shërbimi, cilësitë, klasa, shkolla, periferia në raport me qendrën e qytetit, po patjetër.

Emiriana Sako:

Kemi shkolla pa përfunduar, pa rikonstruktuar akoma, por kemi, po pra po ne shërbimin, objektivin e kemi që ta japim shërbimin në ditë të plotë dhe kemi vend për ta përmirësuar veten, po, kjo është.

Luçiano Boçi:

Objektivin e kemi të njëjtë edhe ne si komision edhe ju si drejtues bashkie.

Emiriana Sako:

Mbase kaq aftësi të kam që të kuptoj, e keni të njëjtë, nuk më doli dhe konkluzioni që kaq e kuptoj.

Luçiano Boçi:

Zoti Arbana, ju si e keni të njëjtë apo e keni me diferencë?

Elton Arbana:

Atëherë shumë shërbime janë të digjitalizuara, pra edhe marrja e lejes së ndërtimit, por edhe në platformën e Jellbenia, në fakt platforma e bashkëqeverisjes është një indikator matës a bëjmë punë mirë ne, pra qoftë në zonat urbane apo në ato rurale, unë do të doja të thoja këtu kam të gjithë historikun, të paktën në pesë vitet e fundit që në platformën e

bashkëqeverisjes kemi zero ankesa të qytetarëve ndaj bashkisë së Shjagut dhe në ato raste që kemi patur një javë një ankesë është zgjidhur brenda ditës, kjo tregon që ne punojmë njësoj si në zonat urbane dhe në ato rurale.

Luçiano Boçi:

Faleminderit, po ka dy gjëra, ose nuk ka fare ose ka dhe zgjidhen shpejt, tashim o njëra o tjetra, ti na i the dyja, po sido që të jetë përgjigje është edhe kjo, zonja përfaqësuese.

Bashkia Krujë:

Shërbimet bazë janë që të gjitha njëllor në të gjitha njësitë administrative, si në qendër, si në njësitë administrative, ndërkohë që për shërbimet e tjera normalisht që si në çdo bashki shërbimet kryesore që urbanistikë nuk ka urbanistikë në njësitë administrative, por ama shërbimet bazë janë në të gjitha njësitë administrative.

Luçiano Boçi:

Janë njësoj, domethënë edhe arsimit me klasa kolektive edhe.

Bashkia Krujë:

Tani nuk ka lidhje me ne ajo, ajo është e Ministrisë së Arsimit, nuk është për, nuk është pjesë e bashkisë.

Luçiano Boçi:

Shërbimet arsimore lidhen edhe me bashkinë edhe janë të ndara.

Bashkia Krujë:

Bashkia aktualisht ka vetëm pjesën e mirëmbajtjes së infrastrukturës, për sa i përket pjesës tjetër është e Ministrisë së Arsimit.

Luçiano Boçi:

Edhe për shërbimet sociale i keni psikolog për çdo çështje.

Bashkia Krujë:

Psikolog jo, por ama kemi punonjës social, kemi punonjës social dhe punonjës të parkut.

Luçiano Boçi:

Pra ka diferenca, po nuk duhet t'i pranoni, shumë mirë, mos i pranoni.

Bashkia Krujë:

Tashim nëse juve mendoni që s'du t'i pranoj unë po them kështu.

Luçiano Boçi:

S'ka gjë, mirë dakord, e kuptoj se edhe pozicioni që keni nuk është adekuat me përgjigjen që duhet t'i jepni në komision, megjithatë tani ju folët këtu për funksione që nuk

shoqërohen me kompetenca dhe me mjete financiare, sepse shpesh ngatërrohet funksioni me kompetencën, funksioni është misioni, qëllimi që ka pushteti vendor, ndërsa kompetenca është mekanizmi juridik që ai përdor dhe financa është mekanizmi financiar, janë të lidhura me njëra-tjetrën, në të tillë formë të paktën janë lidhur dhe folët dhe për funksione të paqarta që janë funksione që ndahen midis pushtetit qendror dhe pushtetit lokal dhe këto impaktojnë kompetenca po të paqarta, apo jo? Dhe sigurisht që edhe burimet financiare mungojnë. Gjatë fjalës tuaj folët edhe për bashki që nuk kanë mundësi financiare sikurse bashkia e Durrësit që të ketë të ardhura nga vetë taksat që ajo mbledh. Dhe si? Po jo, e thatë, e thatë në kontekstin, ju dëgjova me vëmendje dhe e mora shënim, ju e thatë që t'i krijohet mundësia, madje u treguat shumë gjeneroze, ja një minutë.

Emiriana Sako:

Thashë për taksat kombëtare.

Luçiano Boçi:

Po mirë pra, po pra për taksat kombëtare që.

Emiriana Sako:

Jo të bashkisë.

Luçiano Boçi:

Jo pra, dhe një herë nuk, zonja Sako, të lutem ma dëgjo deri në fund se e kam shumë të qartë idenë, pra ishit shumë, po ishit shumë solidare, thatë që bashkitë e tjera që nuk kanë mundësi të kenë mbledhje taksave, të ardhura vendore, të ndihmohen më shumë nga buxheti i shtetit.

Luçiano Boçi:

Po pra, po pra e shikon që, domethënë.

Emiriana Sako:

Jo për taksat vendore, se cituat taksat vendore.

Luçiano Boçi:

Po dhe një herë.

Emiriana Sako:

Që nuk kanë shumë të ardhura taksa vendore, jo, unë thashë që.

Luçiano Boçi:

Mirë, dakord, nuk kanë të ardhura nga burimet e veta, po pra e kuptova.

Emiriana Sako:

Mund të marrim taksa nga Ministria e Shëndetësisë.

Luçiano Boçi:

Po dakord, pra shumë mirë.

Emiriana Sako:

Ministria e Shëndetësisë dhe kjo transferë që na jepet ne mund t'i kalojë bashkive që nuk kanë një shumë.

Luçiano Boçi:

Shumë mirë pra, ja dakord, shumë mirë, u treguat solidare dhe thashë më dëgjo deri në fund se do biem dakord, se normal motamohu s'do e riprodhoja, por në kontekst ta riprodhova. Pra keni parashtruar një sërë shqetësimesh që lidhen, funksionet që lidhin funksionet, kompetencat edhe anën financiare, në këtë parashtrim në fund fare ju mendoni që dështoi reforma e 2014-s në raport me pritshmëritë, se ju thatë në raport me më përpara atje ka mendim përbashkët që ka një lloj evolucioni se konsolidimi ka sjellë disa menaxhime që janë efikase, tani në raport me pritshmëritë se për këtë është komisioni, prandaj është thirrur, në raport me pritshmëritë, jo me 373-shin, ne s'do korrigjojmë 373-shin, jemi për 61-shin, duke qenë se kjo nuk funksionoa, kjo nuk funksionon, kjo nuk funksionon, atëherë konkludimi a ka dështuar apo jo, se është kjo pyetjen e terrë dhe asnjë s'guxon ta thojë që po, më ka dështuar, ne duam që të rregullohet. Ta mendosh këtë problem. Ta mirë, mendoje dhe ma thuaj.

Emiriana Sako:

Duhet ta mendosh që ta thuash, unë nuk e them dot se nuk e mendoj, unë mendoj që reforma ka qenë sukses, ne japim sot më shumë shërbime për qytetarët, pastrohen më shumë, janë bërë më shumë shkolla, bashkitë ka më pak bashki që kanë borxhe dhe ky është fakt, patjetër që është sukses, ama duhet të punojmë që të bëjmë akoma më shumë.

Luçiano Boçi:

Shumë mirë, fryma pozitiviste është shumë e domosdoshme dhe në këtë qytetin kuadrin e kësaj, domethënë që se ka një kundërshti logjike, ne funksionet i kemi të paqarta se ndërhyjnë qeveria, kompetencat gjithashtu se ndërhyjnë qeveria dhe lekë nuk kanë shumë bashki, po kjo nuk shkon me logjikën që cilësia e shërbimeve është rritur dhe numri i tyre është rritur, ka alogjizëm këtu, se në qoftë se në fund fare shërbimet janë rritur, ky është qëllimi i pushtetit vendor, atëherë pse do bëjmë reforme, që e kemi shumë mirë, duhet të bëjmë shumë mirë, shumë më mirë duhet ta bëjmë, por mos harroni që ka, po, po ka një strategji të pushtetit vendor të miratuar në 2023-shin, e cila do bënte atë fuzionimin e aspektit ligjor të pushtetit vendor organik me ligjet e tjera të nxjerra nga qeveria sektoriale që nuk marrin kompetencat, nuk marrin anën, nuk kurzojnë anën financiare, pra në këtë rast kjo duhet të kishte ndodhur, nuk është pjesë e komisionit tonë, ne gjithçka e dimë me kë e kemi të lidhur, me territorin, sepse dalim këtu, kjo është pjesë që duhet të ishte bërë nga politikat qeverisëse dhe dalim tek impakti që sjell territori, bashkia e madhe e largon qytetarin, je bashki shumë e madhe, është Manza, është Ishmi, ka probleme të tjera atje, probleme natyrë tjetër Durrësi, urban natyrë tjetër atje dhe kjo e vë në ngërç një bashki shumë të madhe dhe krijon probleme, prandaj ne në fund fare themi që gjithçka na çon tek territori. Sepse dalim te bashkia e Durrësit, domethënë sepse nuk dua ta zgjas me bashkitë e tjera, është shembull i bashkisë së madhe që ka një bazë fiskale të shëndoshë, ka të ardhura të shëndosha, por ama në treguesit e performancës është ndër bashkitë problematike dhe një nga problemet kryesore është menaxhimi i mbetjeve që e trajtoi zoti Cara, sepse çmimi i pagesës për tonë, po, është shumë i lartë, është 15,300 lekë,

domethënë është nxjerrë nga KLSH-ja, më duket, 15,000 dhe konsiderohet shumë e lartë në raport edhe me parametrat.

Luçiano Boçi:

OKB-ja thotë që shumë e lartë duhet të jetë dhe në mos gaboj, se ndoshta KLSH-ja ka raportin e vet dhe referenca nga KLSH-ja është që ju shpenzoni 30% të buxhetit për çështjen e menaxhimit të mbetjeve dhe kjo mund të duket kosto shumë e lartë për atë ekonominë e shkallës, sepse e gjithë kjo bie si barrë mbi qytetarin, ndërkohë që ekonomia e shkallës thotë që për shërbime ne duhet të kemi shpenzime më të vogla në raport me një bashki të vogël. Në këtë rast, domethënë, kjo tregon që modeli i bashkisë së madhe nuk përputhet patjetër me suksesin, apo jo?

Emiriana Sako:

Tani ju, deri tani bëtë koment, Durrësi sot, Durrësi sot është, Durrësi sot është dhjetëra herë më i pastër sesa para reformës, qoftë qyteti, qoftë njësitë administrative, patjetër, e padiskutueshme, ka kosto, po, mund t'i minimizojmë, po, me ato që u përmendën pak më, pak më shpejt, nuk duhet të flas për emrat për veshën, unë po flas për, unë po flas për reformën këtu, sot Durrësi është shumë herë më i pastër sesa ka qenë dhjetë vite përpara dhe këtu nuk flasim vetëm për Durrësin e vogël, flasim për gjithë njësitë administrative dhe për gjithë territorin që përfshin qytetin e Durrësit.

Luçiano Boçi:

Zonja Sako, po faleminderit, dakord jam me këtë që mund të konstatojmë ju se ne akoma nuk e dimë që është më i pastër, apo jo? Po, por çështja është që ne po diskutojmë për kostot këtu dhe për ekonominë e shkallës, për efikasitetin e pushtetit vendor, dakord, ne e duam edhe Tiranën shumë më të pastër, po s'mund të harxhojmë 50 euro për tonë, për shembull, se ka një logjikë menaxhuese, menaxhimi, po 29, e thashë kështu në opsionalitet, nuk mund.

Emiriana Sako:

Po jo opsionale, thuaj sa është, pse opsionale?

Luçiano Boçi:

Zonja Sako.

Emiriana Sako:

Po nuk mund t'ju lë që të thoni gjëra e senë të vërteta.

Emiriana Sako:

Pra është 29 euro, ju thoni 50 euro, po keqinformoni qytetarët, po ata që keni.

Luçiano Boçi:

A nuk e kupton parashtrimin, zonja Sako? Jo, jo, një problem.

Emiriana Sako:

Jo, e tha, është hera e dytë që e thoni që nuk kupton, tani ky mund të jetë konstatimi juaj, mua mund të më ofendoni.

Luçiano Boçi:

Po mirë, dëgjo Luçjano, po ta them shumë qartë, nuk ju referova 29-tës, se 29-ta është e përlogaritur dhe po them, nuk mund të dalim mbi përlogaritjet normale, pra në qoftë se është 29, ka disa arsye këtu në Tiranë, pra thashë, nuk mund ta pranojmë të bëhet 50, se e duam akoma më të pastër, jo, se ka një logjikë, po thoja, ekonomike, pra nuk ju referova një shifre të saktë, domethënë, thashë, nuk mund ta tejkalojmë, pra edhe bëra një ballafaqim me Durrësin, pra pse nuk ka një kosto më të vogël, sepse bashki të tjera që kanë një kosto shumë më të vogël, tre herë më të pakët se Durrësi, është konstatuar nga KLSH-ja, jo nga mua, e kanë qytetin po aq të pastër, po aq turistik, prandaj këtu, domethënë, ose ka abuzim, ose kontraktimet tuaja nuk janë të favorshme për bashkinë, duhet t'i ndryshoni.

Emiriana Sako:

Ne kemi shërbim, ne kemi politikë.

Luçiano Boçi:

Dhe prandaj po them që kjo nuk tregon që një bashki e madhe krijon patjetër ekonominë e shkallës dhe performancën e ka më të mirë se një bashki mesatare siç është bashkia e Shijakut, ajo ka problemet e veta, se ka problem me venddepozitimin e mbetjeve, apo se bashkia e Krujës, një tjetër që s'e kemi këtu, në këtë kuptim e kisha, po e kuptoj që jeni shumë pozitivë vështirë.

Emiriana Sako:

Jo, s'jam fare në pozitivë vështirë.

Luçiano Boçi:

Dakord, me ju kuptojmë shumë mirë, s'ka asgjë që.

Emiriana Sako:

Kam opinionin tim të bazuar mbi fakte dhe sigurisht mund të bëni dhe sondazhin terren, në qoftë se jeni të merakosur edhe për pastërtinë e qytetit të Durrësit.

Luçiano Boçi:

Jo, unë fare s'jam i merakosur për pastërtinë e Durrësit, unë jam i merakosur për lekët që paguajnë qytetarët, për atë pastërti që mund të arrijnë më shumë.

Emiriana Sako:

Është një ndër shërbimet më të rëndësishme që kanë, ose më të vështira që kanë kryetarët e bashkive.

Luçiano Boçi:

Dakord, dakord.

Emiriana Sako:

Dhe ne sot Durrësin e kemi më të pastër sesa një dekadë më parë, kaq mund ta them me siguri.

Luçiano Boçi:

E di, e di, jo, këtë nuk e di të pastërtisë, çështja është që.

Emiriana Sako:

Pastaj, po e përsëris, për të minimizuar kostot, patjetër ne do të bëjmë ca hapa të tjerë, që i kemi marrë angazhimet, po pra, po nuk bëhet në një ditë puna e një kryetari të qytetit.

Luçiano Boçi:

Jo, as me dhjetë vite nuk bëhet.

Emiriana Sako:

Do një mandat, që ato premtime që i ke dhënë qytetarëve, t'i zbatosh patjetër.

Luçiano Boçi:

Po, po, sa e ke në plan, domethënë, me ul, se ju e keni rritur në progresivitet, gjithsesi mos zgjatemi, se ndonjëherë e shikon.

Emiriana Sako:

Mund ta diskutojmë më gjatë këtë çështje.

Luçiano Boçi:

Jo, jo, Sako, e kam më thjeshtë për debatin, e shikon, e shikon si ndiqet.

Luçiano Boçi:

Sara, Sara, një minutë, e shikon si, domethënë, futet debati në ca enklavat që s'duhet të futet, po futet, vjen natyrshëm, se ne s'marrim përgjigjen e duhur, unë jap, bëj tjetër pyetje, marr një përgjigje krejt tjetër dhe shumë mirë ju kuptojmë me mirëkuptimin e bashkëkryetarit, unë e konsideroj të mbyllur dëgjessën me qarkun e Durrësit. Faleminderit për përgjigjet pa përgjigje.

Elton Arbana:

Jo, ne jemi përgjigjur.

Emiriana Sako:

Ju mirëpresim në Durrës në datë 19-të që kemi dëgjessën me qytetarët për të folur dhe ata.

Arbjan Mazniku:

Zonja Sako, shumë faleminderit dhe gjithë kryetarëve.

Emiriana Sako:

Datë 19-të, më duket.

Arbjan Mazniku:

Ju uroj shumë ndjesë për faktin që ju kanë marrë kohën me të padrejtë një seri deputetësh.